

EPOKA ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5768
E shtunë, 4 maj 2019
çmimi 0.40 €

Kosova shkon në Samitin e Parisit me qëndrim të përbashkët për dialogun



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", BURIM RAMADANI



Rruga e Kosovës drejt NATO-s do të jetë e sigurt

Koordinatori Nacional për Integrim dhe Anëtarësim në NATO, Burim Ramadani, ka bërë me dije se, pavarësisht kohës që merr, rruga e Kosovës drejt NATO-s është e sigurt. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se qysh tani Kosova është e gatshme të kontribuojë për paqen dhe sigurinë globale. Sipas Ramadani, me funksionalizimin e Komitetit Ndërmëtor për Anëtarësim dhe Integrim në NATO, Kosova ka institucionalizuar aspiratat e popullit dhe institucioneve të veta për anëtarësim në NATO. Ai ka theksuar se në aspektin politik dhe diplomatik, Komiteti Ndërmëtor synon të analizojë dhe rekomandojë për qeverinë rrugëzgjdhjet më të përshtatshme për avancimin e pozitës së Kosovës në raportet me NATO-n

AKTUALE

AGJËRIMI I RAMAZANIT
FILLON TË HËNËN F. 2

NË UP HAPET EDICIONI I
NËNTË I PANAIRIT VIRTUAL TË
KARRIERËS F. 7

NGRIHET AKTAKUZË NDAJ DY
PERSONAVE PËR SHPËLARJE
TË PARAVE F. 10

EKONOMI

GENERAL ELECTRIC
PËRZGJEDHET OFERTUESI
I PREFERUAR PËR
TERMOCENTRALIN
'KOSOVA E RE' F. 9

Veseli: Nuk mund të ketë pajtim me Serbinë pa sjelljen në vend të drejtësisë për krimet e luftës

Kryeparlamentari Kadri Veseli në një konferencë për media mbajtur të premten ka bërë me dije se ka nisur konsultat dhe procedurat të cilat shumë shpejt do të rezultojnë me hapa konkretë drejt formimit të gjykatës ndërkombëtare për krimet dhe gjenocidin që Serbia ka kryer në Kosovë. Ai ka pohuar se 186 masakra të kryera nga Serbia në Kosovë kërkojnë drejtësi dhe heshtja ndaj



dëshmime dhe dëshmitarëve është falje e heshtur për kriminelët



Mustafa:
Ndryshimi i
kufijve do të
nënkuptonte
hapje të
shtetësisë së
Kosovës

LLUKA: TELEKOMI NË PRAG
TË FALIMENTIMIT F. 9

KULTURË

PRERJA E
FRIKËS SI
PARABOLË F. 12

Prof. dr. Hysen
MATOSHI



SPORT

GËRBESHI: PËR HIR
TË KAMPIONATIT DUAM
FITORE NDAJ PRISHTINËS F. 16



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Veseli: Nuk kam ftesë nga Specialja dhe nuk jam duke shkuar në Hagë

PRISHTINË, 3 MAJ - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, të premten e ka demantuar lajmin se ka marrë ftesë për t'u intervistuar nga Gjykata Speciale në Hagë. "Nuk kam ftesë dhe nuk jam duke shkuar në Hagë, as për

vizitë dhe as për Gjykatën Speciale. Nuk është e vërtetë që kam ftesë për ndonjë intervistë. Po të kisha do ta bëja njoftimin publik. Nuk është marre, as kiamet. Më vjen keq në qoftë se dikush është shqetësuar për këtë

lajm, por më vjen keq edhe për ata që i janë gëzuar këtij lajmi. E kam thënë edhe më parë se askush nuk më frikëson. Vetëm kombi im mund të më gjuhëzojë apo përkrahë", ka shkruar Veseli në llogarinë e vet në "Facebook".



Maqedonia Veriore nesër zgjedh presidentin

Në rrethin e dytë për zgjedhjen e presidentit garojnë Stevo Pendarovski si kandidat i përbashkët i partnerëve të koalicionit qeverisës dhe Gordana Siljanovska Davkova e mbështetur nga VMRO-DPMNE-ja, të cilët fushatën zgjedhore e fokusuan te qytetarët e papërcaktuar dhe te votat e shqiptarëve



SHKUP, 3 MAJ - Nesër (e diel) qytetarët e Maqedonisë Veriore do të votojnë në raundin e dytë për ta zgjedhur kreun e shtetit. Për të qenë i vlefshëm rrethi i dytë zgjedhor duhet të dalin 40 % e numrit të përgjithshëm të votuesve, apo mbi 700 mijë vota. Në rrethin e parë të zgjedhjeve pati mbi 41 % dalje. Në garë në rrethin e dytë janë kandidatë Stevo Pendarovski si kandidat i përbashkët i partnerëve të koalicionit qeverisës dhe Gordana Siljanovska Davkova e mbështetur nga VMRO-DPMNE-ja.

Nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve thonë se materiali zgjedhor është i gatshëm dhe se presin që të arrihet pragu. Pjesa e dytë e fushatës zgjedhore për raundin e dytë të zgjedhjeve u fokusua te qytetarët e papërcaktuar dhe te

votat e shqiptarëve. Kandidati për president Stevo Pendarovski, i mbështetur nga LSDM-ja dhe partitë e koalicionit, tha se qytetarët që kanë vendosur të bojkotojnë, duhet të rimendohen sepse qëndrimi i tyre në shtëpi gjatë së dielës do ta favorizonte kundërkandidaten e tij, VMRO-DPMNE-në dhe Nikolla Gruevskin. Pendarovski vazhdimisht ka theksuar se programi i tij është pro-evropian dhe me vizionin për një shtet të të gjithë qytetarëve, pa dallime fetare apo etnike, ka njoftuar "Alsat-M". "Për këtë vendim është i rëndësishëm çdo qytetar. Zëri i gjithsecilit është i rëndësishëm. Është i rëndësishëm zëri në kuti, por edhe i atyre që në raundin e parë kanë qëndruar në shtëpi. Edhe njëri edhe tjetri përcjellin mesazh të rëndë-

sishëm dhe ai mesazh është pranuar. Ju siguroj se do ta kritikoj çdo qeveri që nuk do të dëgjojë zërin e qytetarëve. Do të gjykoj ndonjërin që nuk do të veprojë për të drejtat e qytetarëve, që do të punojë kundër demokracisë dhe drejtësisë dhe që do tentojë të krijojë ndarje dhe konflikte", theksoi Stevo Pendarovski.

Kryeministri Zoran Zaev nga tubimi në Ohër tha se vetëm të

bashkuar mund të tejkalohen të gjitha barrierat, duke përmendur këtu si kundër shembull, retorikën e përdorur nga kandidatja e mbështetur nga partia opozitare maqedonase, VMRO-DPMNE. "Krahu tjetër nuk i dashka shqiptarët. Ja si mbaron fushata. Madje edhe kandidati i tretë, thërret që të votohet për NATO dhe BE. Gjithçka është e qartë, dilni dhe votoni për NATO-n dhe

BE-në, dilni dhe votoni pra për Stevo Pendarovskin. Sepse ajo është e ardhmja, s'ka se çfarë të vendoset. Nga njëra anë keni koncept që e forcon bashkimin. Në anën tjetër keni koncept, ku nuk ka koncept. Alternativë, pa alternativë, asgjë, zero, patate", tha Zoran Zaevi. Zaevi dhe Pendarovski u shprehën optimistë sa i takon arritjes së pragut në raundin e dytë të zgjedhjeve.

Presidenti Meta në inaugurimin e Xhamisë së re të Stambollit



TIRANË, 3 MAJ - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, të premten ka marrë pjesë në inaugurimin e xhamisë së re të Stambollit, Çamlica. Ka qenë vetë kreu i shtetit që e ka bërë njoftimin në llogarinë e vet në "Facebook". "Kënaqësi të merrja pjesë sot në inaugurimin e xhamisë së re të

Stambollit, Çamlica. Një vepër e rëndësishme shpirtërore, kulturore dhe arkitekturore në kryeqendrën dhe pikëtakimin e civilizimeve botërore", ka shkruar Meta. Mungesa e kryeministrit Rama sigurisht se bie në sy pasi ai ka qenë i pranishëm thuajse në

çdo organizim me personalitete ndërkombëtare të presidentit turk Tajip Erdogan. Kohët e fundit është përfolur se marrëdhëniet mes dy liderëve, Rama - Erdogan, të cilët shpesh i janë drejtuar njëri-tjetrit me termin "vëlla", nuk janë më aq vëllazërore.

Agjërimi i Ramazanit fillon të hënën

PRISHTINË, 3 MAJ (ER) - Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës ka njoftuar besimtarët myslimanë dhe gjithë opinionin e gjerë, se muaji i madhëruar i Ramazanit fillon ditën e hënë (6 maj). "Me

rastin e fillimit të muajit të madhëruar të Ramazanit, Kryesia e BI-së përgëzon besimtarët myslimanë në Kosovë, diasporë e trojet tona, duke u dëshiruar agjërimit të lehtë, shtim të ibadetit

dhe solidaritet me nevojtarët. Me fat muaji i madhëruar i Ramazanit! Agjërimit të lehtë dhe të pranuar!", është thënë në njoftimin e Bashkësisë Islame të Kosovës.



Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka mbajtur konferencë për media

Veseli: Nuk mund të ketë pajtim me Serbinë pa sjelljen në vend të drejtësisë për krimet e luftës

Kryeparlamentari Kadri Veseli, në një konferencë për media mbajtur të premtën, ka bërë me dije se ka nisur konsultat dhe procedurat të cilat shumë shpejt do të rezultojnë me hapa konkretë drejt formimit të gjykatës ndërkombëtare për krimet dhe gjenocidin që Serbia ka kryer në Kosovë. Ai ka pohuar se 186 masakra të kryera nga Serbia në Kosovë kërkojnë drejtësi dhe heshtja ndaj dëshmive dhe dëshmitarëve është falje e heshtur për kriminelët

gjithe kriminelët serbë që fshihen në Serbi, se do të zihen e do të gjykohen për krimet që kanë kryer në Kosovë. "Mesazhi për të gjithë kriminelët në Serbi është i qartë. Kemi për t'ju zënë të gjithëve. Do të përgjigjeni për atë që ua keni bërë njerëzve tanë në Kosovë, që nga fëmijët deri te pleqtë të cilët kanë qenë të pafajshëm, e ju nuk keni qenë të zotë për t'u ballafaquar me ne, Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës", ka thënë Veseli.

Kryetari i Kuvendit ka theksuar se institucionet e Republikës së Kosovës e kanë obligim ta mbrojnë jo vetëm lirinë, shtetin dhe jetën e qytetarëve, por edhe të

vërtetën e luftës sonë çlirimtare. "Krimet dhe masakrat e kryera nga Serbia në Kosovë janë të përmasave të gjenocidit. Ne kemi besuar se drejtësia ndërkombëtare do ta thotë fjalën e vet në dënimin e këtyre krimeve. Fatkeqësisht, kanë kaluar dy dekada dhe pak ose aspak nuk është bërë në këtë drejtim. Tribunali i Hagës i ka lënë në gjysmë proceset gjyqësore kundër krerëve të regjimit të Millosheviqit. Për atë që edhe drejtësia ndërkombëtare në Kosovë nuk e ka kryer punën e saj. Ndërkaq, Serbia është mundur ta mbyllë këtë punë duke organizuar gjykime të rrejshme

të oficerëve të saj që kanë marrë pjesë në masakrat e kryera në Kosovë. Kjo është e papranueshme", është shprehur kryeparlamentari Veseli. Ai ka shtuar se, ndonëse Serbia u largua nga Kosova në vitin 1999, përpjekjet e saj sistematike për ta penguar shtetndërtimin dhe të ardhmen e Kosovës kanë vazhduar dhe ende vazhdojnë. Këto përpjekje, ka shtuar Veseli, janë përpjekje për të ndryshuar edhe të vërtetën mbi të kaluarën e Kosovës, të vërtetën mbi gjenocidin e ushtruar nga shteti serb. Ai ka thënë se nuk mund të ketë një pajtim pa sjelljen në vend të drejtësisë për krimet e luftës.

**EPOKA
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 3 MAJ - Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kadri Veseli, ka paralajmëruar të premtën hapat konkretë për formimin e një gjykate ndërkombëtare, e cila do t'i ndëshkojë krimet e Serbisë në Kosovë. Në një konferencë për media, kryeparlamentari Veseli ka thënë se tashmë ka nisur konsultat dhe procedurat të cilat shumë shpejt do të rezultojnë me hapa konkretë drejt formimit të gjykatës ndërkombëtare për krimet dhe gjenocidin që Serbia ka kryer në Kosovë. "Unë kam marr iniciativën për ta filluar procesin i cili do të rezultojë me krijimin e një gjykate ndërkombëtare për masakrat e kryera nga Serbia në Kosovë në vitet 1998-1999. Kjo gjykatë është e mundur dhe e domosdoshme dhe do të ndodhë. Shteti i Kosovës ka për obligim që t'i marrë të gjitha veprimet për ta bërë atë të pashmangshme. Rruga e pajtimit historik dhe e paqes së përhershme në mes të Kosovës dhe Serbisë kalon vetëm përmes drejtësisë", ka thënë kryeparlamentari Veseli. Ai ka pohuar se 186 masakra të kryera nga Serbia në Kosovë kërkojnë drejtësi dhe heshtja ndaj dëshmive dhe dëshmi-

tarëve është falje e heshtur për kriminelët.

Veseli ka thënë se kjo nuk bën të ndodhë dhe nuk do të lejohet të ndodhë, ndërsa i porositi të



Përrurohet Dhoma e Dëshmive në Inspektoratin Policor



PRISHTINË, 3 MAJ (ER) - Në ndërtesën e Inspektoratit Policor të Kosovës (IPK) në Hajvali është mbajtur të premtën ceremonia e përrurimit të "Dhomës së dëshmive të IPK-së" si donacion nga OSBE-ja. Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues të lartë të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare.

Kryeshëfja ekzekutive e IPK-së, Miradie Kelmendi, pasi ka falënderuar OSBE-në për donacionin, ka folur për rëndësinë e këtij bashkëpunimi me OSBE-në, i cili daton që nga viti 2006, vit i

themelimit të IPK-së. "OSBE-ja ka mbështetur projektin tonë për rregullimin e kushteve teknike dhe të sigurisë për Dhomen e Dëshmive, e cila deri më tani i ka munguar organizatës sonë", ka thënë Kelmendi, duke theksuar se janë të përkushtuar të punojnë në drejtim të ngritjes së integritetit policor, duke realizuar një mbikëqyrje demokratike, të përgjegjshme dhe profesionale në Policinë e Kosovës. Zëvendësministri i Punëve të Brendshme, Imzi Zeka, e ka vlerësuar IPK-në si një nga institu-

cionet më kredibile të Kosovës. Ai ka thënë se është i bindur që me këtë donacion puna e IPK-së do të jetë edhe më profesionale, pasi dëshmitë që sigurohen gjatë hetimeve kanë një vend tashmë të sigurt dhe me standarde për ruajtjen tyre. Ndërsa zëvendësambasadori i OSBE-së, Kilian Vahl, ka thënë se me këtë donacion, edhe me aktivitetet tjera, kanë synuar që Inspektorati Policor i Kosovës t'i ketë standardet e policive ndërkombëtare dhe në përputhje me standardet e Kodit Evropian të Etikës Policore.

Flet për "Epokën e re", Burim Ramadani

Rruga e Kosovës drejt NATO



Koordinatori Nacional për Integrim dhe Anëtarësim në NATO, Burim Ramadani, ka bërë me dije se, pavarësisht kohës që merr, rruga e Kosovës drejt NATO-s është e sigurt. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se qysh tani Kosova është e gatshme të kontribuojë për paqen dhe sigurinë globale. Sipas Ramadani, me funksionalizimin e Komitetit Ndërmintor për Anëtarësim dhe Integrim në NATO, Kosova ka institucionalizuar aspiratat e popullit dhe institucioneve të saj për anëtarësim në NATO. Ai ka theksuar se në aspektin politik dhe diplomatik, Komiteti Ndërmintor synon të analizojë dhe rekomandojë për qeverinë rrugëzgjdhjet më të përshtatshme për avancimin e pozitës së Kosovës në raportet me NATO-n

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 3 MAJ - Koordinatori Nacional për Integrim dhe Anëtarësim në NATO, Burim Ramadani, ka deklaruar se Kosova është plotësisht e gatshme të kontribuojë për paqen dhe sigurinë globale. Ai ka treguar se me funksionalizimin e Komitetit Ndërmintor për

Anëtarësim dhe Integrim në NATO, Kosova ka institucionalizuar aspiratat e popullit dhe të institucioneve të Kosovës për anëtarësim në NATO. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Ramadani ka thënë se kontributi i Kosovës do të jetë krah për krah me NATO-n, kudo që mund të kërkohej. "Shteti dhe populli ynë ka marrë mbështetje në kohën e vështirë për ne.

Tashmë 20 vjet më pas, Kosova është plotësisht e gatshme të kontribuojë për paqen dhe sigurinë në cilëndo zonë të globit. Kosova është shembulli më i mirë i suksesit në epokën tonë. Kontributi i Kosovës do të jetë krah për krah me NATO-n kudo që mund të na kërkohej", ka thënë Ramadani.

Në bazë të kapaciteteve të specializuara të institucioneve të

sigurisë, ai ka thënë se Kosova mund të marrë përgjegjësinë për t'i ndihmuar popujt e tjerë për stabilizim, paqe dhe siguri.

Ramadani, i cili është edhe zëvendësministër i Mbrojtjes, ka thënë se komiteti është një mekanizëm koordinues i politikave, angazhimeve, komunikimit strategjik dhe qasjes nacionale në raportet me NATO-n. "Në aspektin politik dhe diplomatik, Komiteti Ndërmintor synon të analizojë dhe rekomandojë për qeverinë rrugëzgjdhjet më të përshtatshme për avancimin e pozitës së Kosovës në raportet me NATO-n. Duke qenë se deri më tash Kosova ka marrëdhënie korrekte me NATO-n, ne sigurisht se synojmë të avancojmë këtë marrëdhënie në një fazë të fillimit të procesit të anëtarësimit", është shprehur ai. Ramadani ka thënë se, pavarësisht kohës që merr, rruga e Kosovës drejt NATO-s do të jetë e sigurt. "Në aspektin teknik dhe

institucional Kosova ka përparësi të dukshme. Përparësia kryesore është fakti se Kosova edhe me kapacitetet ekzistuese është e ndërveprueshme me NATO-n, ndërsa të gjitha planifikimet për të ardhmen janë në përputhje me standardet e NATO-s", është shprehur ai.

"Epoka e re": Z. Ramadani, kryeministri Haradinaj ka njoftuar për funksionalizimin e Komitetit Ndërmintor për Anëtarësim dhe Integrim në NATO. Cili do të jetë roli i këtij komiteti dhe kush do ta përbëjë atë?

Ramadani: Aspirata e popullit dhe institucioneve të Kosovës për anëtarësim në NATO është institucionalizuar. Ky është hapi i parë zyrtar përmes themelimit të Komitetit Ndërmintor për Integrim dhe Anëtarësim në NATO. Është një mekanizëm koordinues i politikave, angazhimeve, komunikimit

O-s do të jetë e sigurt

nuk është shtet neutral ushtarakisht. Ne duam të anëtarësohemi në NATO si pjesë e familjes euroatlantike për ta ndihmuar dhe mbështetur paqen, sigurinë dhe demokracinë në rajon dhe kudo nëpër botë. Shteti dhe populli ynë kanë marrë mbështetje në kohën e vështirë për ne. Tashmë 20 vjet më pas, Kosova është plotësisht e gatshme të kontribuojë për paqen dhe sigurinë në cilëndo zonë të globit. Kosova është shembulli më i mirë i suksesit në epokën tonë. Kontributi i Kosovës do të jetë krahas krahas me NATO-n kudo që mund të na kërkohet. Në bazë të kapaciteteve të specializuara të institucioneve të sigurisë, në rend të parë të FSK-së, Kosova mund të marrë përgjegjësinë për të ndihmuar popujt e tjerë në stabilizim, paqe dhe siguri. Në aspektin politik dhe diplomatik, Komiteti Ndërmintor synon ta analizojë dhe rekomandojë për qeverinë rrugëzgjdhjet më të përshtatshme për avancimin e pozitës së Kosovës në raportet me NATO-n. Duke qenë se deri më tash Kosova ka marrëdhënie korrekte me NATO-n, ne sigurojmë se synojmë të avancojmë këtë marrëdhënie në një fazë të fillimit të procesit të anëtarësimit.

"Epoka e re": Më herët ju nga kryeministri jeni emëruar edhe Koordinator Nacional për Integritet dhe Anëtarësim në NATO. Cilat do të jenë përgjegjësitë e juaja?

Ramadani: Komiteti Ndërmintor për NATO është konstituuar me takimin e parë që është mbajtur të enjten. Fakti që kryeministri Haradinaj ka udhëhequr vetë takimin e parë dëshmon për përkushtimin dhe vendosmërinë e tij për ta avancuar punën në këtë Komitet dhe

për ta avancuar rrugën e Kosovës drejt NATO-s. Më tutje, kërkohet puna në koordinimin e institucioneve të përfshira në këtë fushë dhe ky është roli i përgjithshëm i Koordinatorit Nacional. Përgjegjësitë e kësaj detyre janë të përcaktuara në vendimin e Qeverisë së Kosovës, të datës 18 prill 2019. Sipas këtij vendimi, përgjegjësitë kryesore ndërlihem me punën për hartimin e platformës nacionale të politikave të integritetit në NATO, udhëheqjen dhe ndjekjen e ecurisë së këtij procesi, paraqitjen para Qeverisë së Republikës së Kosovës për miratim të dokumenteve strategjike dhe planeve të veprimit në baza periodike. Po ashtu, përfshihet edhe komunikimi në emër të Republikës së Kosovës, sipas koordinimit me kryeministrin e Kosovës, në raport me NATO-n dhe faktorin ndërkombëtar të pranishëm në Kosovë që ndërlihet me NATO-n apo shtetet anëtare të NATO-s.

"Epoka e re": Emërimi juaj në këtë pozitë është kritikuar nga shoqëria civile, duke u parë si përzierje e kompetencave me Ministrinë e Mbrojtjes?

Ramadani: Kosova ka marrë shembuj të praktikave të suksesshme të shteteve të tjera, sidomos nga rajoni ynë. Ministria e Mbrojtjes është anëtare aktive e këtij Komiteti Ndërmintor, duke u përfaqësuar në dy nivele lidhshme, pra edhe me Ministrinë e Mbrojtjes, edhe me komandantin e FSK-së. Porse, avancimi i politikave drejt NATO-s është fushë që përfshin shumë institucione, mekanizma dhe nivele. Anëtarësimi në NATO është proces gjithëpërfshirës. Kërkon angazhim të shumë institucioneve dhe, si të tilla, koordinimi i politikave dhe institucioneve në

këtë fushë është i domosdoshëm. Shtetet në rajon kanë pasur dhe vazhdojnë të kenë zyra të posaçme për të koordinuar. Qeveria e Kosovës ka vendosur që ta funksionalizojë koordinimin për NATO përmes kapaciteteve ekzistuese në qeveri, prandaj në të vërtetë është shmangie e rritjes së zyrave të veçanta. Ndërsa në fushën qeverisëse të mbrojtjes, angazhimi ynë është i përbashkët në baza të përditshme. Nën udhëheqjen e ministrit Rustem Berisha, tashmë Ministria e Mbrojtjes ka hyrë në fazë të rëndësishme të riorganizimit dhe vendimmarrjes së politikave për avancimin dhe modernizimin e sistemit të mbrojtjes në përgjithësi. Gjithçka sipas planifikimeve afatgjata, porse të koordinuara mirë me partnerët strategjikë dhe me institucionet e Kosovës.

"Epoka e re": Sa e gjatë do të jetë rruga e Kosovës drejt anëtarësimit në NATO?

Ramadani: Kosova beson në politikën e dyerve të hapura që ka NATO-ja, edhe bazuar në Nenin 10 të Paktit Verio-Atlantik. Jam i bindur se vazhdimi i zgjerimit të NATO-s në rajonin tonë është garanci për paqen dhe sigurinë, si dhe konsolidimin e demokritizimit të shteteve. Ne jemi të kënaqur me bashkëpunimin që kemi në bërjen e Kosovës të sigurt dhe të mbrojtur, sikurse edhe në ndërtimin e kapaciteteve institucionale të Kosovës në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes. Nuk është arrogante të pretendojmë që Kosova të jetë shteti i radhës që anëtarësohet në NATO. Sidomos tashmë pas avancimit të procesit deri në hapat e fundit të anëtarësimit të Maqedonisë së Veriut në NATO.

Kosova është rreshtuar institu-

cionalisht kah NATO-ja. Në të vërtetë, do të donim që të shohim të gjitha shtetet e rajonit që t'i bashkohen NATO-s, sepse kjo është çështje që duhet ta shohin secili shtet jo vetëm për vete, por edhe për kontributin në sigurinë rajonale. Në aspektin politik e diplomatik, angazhimet e përbashkëta me NATO-n dhe me shtetet veç e veç do të jenë fokusi kryesor. Në aspektin teknik dhe institucional, Kosova ka përparësi të dukshme. Përparësia kryesore është fakti se Kosova edhe me kapacitetet ekzistuese është e ndërveprueshme me NATO-n, ndërsa të gjitha planifikimet për të ardhmen janë në përputhje me standardet e NATO-s. Pavarësisht kohës që merr, rruga e Kosovës drejt NATO-s do të jetë e sigurt.

"Epoka e re": Kosova është duke kaluar në procese të ndryshme politike, ku jo rrallë po ndodhin kushtëzime të ndryshme. Afrimi i Kosovës me NATO-n, a mund të ndërlihet me procese të tjera?

Ramadani: Ne jemi në fazën fillestare të procesit. Më e rëndësishmja në këtë pjesë është që Kosova kupton procesin në tërësi, rrethanat, implikimet, procedurat dhe vullnetin e deklaruar tashmë institucional. Kosova edhe sot punon me NATO-n, përmes Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës (NALT), sikurse edhe në programin që kemi "Ndërveprimi i zgjeruar". Bashkëpunojmë edhe me misionin e KFOR-it, i udhëhequr nga NATO, për ta zhvilluar dhe mirëmbajtur sigurinë në Kosovë. Shteti ynë, në tërësi, do të kalojë nëpër disa faza drejt NATO-s. Të gjitha këto do të bëhen në koordinim të plotë.

strategjik dhe qasjes nacionale në raportet me NATO-n. Kosova

Mustafa: Ndryshimi i kufijve do të nënkuptonte hapje të shtetësisë së Kosovës

PRISHTINË, 3 MAJ - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, ka thënë se Samiti i Berlinit i ka dhënë fund korrigjimit të kufijve. Pas takimit me kryetarët e degëve të LDK-së, në një konferencë për media të premtën, Mustafa ka deklaruar se ndryshimi i kufijve është ndryshim i deklaratës së pavarësisë. "Edhe sot në kryesi janë hapur shumë çështje të situatës politike në vend, asaj që ka të bëjë me dialogun, veçmas të Samitit në Berlin. Konfliktet dhe mosmarrëveshjet që kemi mes liderëve institucionalë po lënë

një figurë dhe përshtypje shumë të keqe, në një proces me Serbinë dhe në njohjen reciproke", ka thënë ai. Sipas Mustafës, e vetmja zgjidhje për të dalë nga situata në Kosovë janë zgjedhjet e parakohshme. "LDK-ja ka pasur të drejtë në qëndrimet që dialogu të mos prekë çështjen e kufijve, shkëmbimin e territoreve apo demarkacionit sepse kjo është rregulluar me Kushtetutë dhe Deklaratën e Pavarësisë dhe një gjë e tillë do të nënkuptonte hapje të shtetësisë së Kosovës. Samiti i Berlinit i ka dhënë kahe kësaj çështje, sepse



ka konsideruar se do të jetë e dëmshme për rajonin nëse hapet çështja e territorit. Si LDK

do të angazhohemi që të gjendet zgjidhje për dialogun dhe mbetet zgjidhja më e mirë

shkuarja në zgjedhje", ka thënë Mustafa.

I pyetur për kërkesën e Merkelit për pezullim të taksës, ai ka thënë se qëndrimet e strukturave politike po ndryshojnë teksa ka shtuar se dialogu nuk duhet të kushtëzohet me taksë. "Taksa nuk është vënë për dialogun. Qeveria e ka marrë këtë vendim dhe ne e mirëpresim këtë qëndrim. LDK-ja konsideron se pas zgjedhjeve në Komisionin Evropian, duhet t'i hapim rrugë këtij procesi, por me një qëndrim unik të Kosovës lidhur me procesin", ka deklaruar Mustafa.

Liria e medias, esenciale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe demokracisë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

Prishtinë, 3 maj - Në Ditën Ndërkombëtare të Lirisë së Shtypit, përfaqësuesit e institucioneve të vendit kanë thënë se liria e shtypit është e drejtë themelore dhe e forcon edhe demokracinë tonë. Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, ka thënë se liria e Kosovës i ka rrënjët edhe në lirinë e shtypit. Ai ka theksuar se ishin mediat e lira ndërkombëtare të cilat pa censurë informuan botën për qindra masakra, për vuajtjet dhe spastrimin etnik që po ndodhte në Kosovë. "Më 1998-1999 liria e shtypit fitoi mbi censurën. Mediat e lira fituan mbi ato të kontrolluara nga regjimi serb. Gazetarët tanë janë rritur me këtë frymë dhe sot, në Ditën Ndërkombëtare të Lirisë së Shtypit, i gëzojemi faktin që kemi krijuar një mjedis për ta ndjekur shembullin e tyre për ta thënë të

vërtetën. Liria e shtypit, liria e shprehjes, e cila është me përgjegjësi të madhe publike, është e drejtë themelore dhe e forcon edhe demokracinë tonë", ka thënë presidenti Thaçi.

Në Ditën Ndërkombëtare të Lirisë së Shtypit, kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se Kosova ka shënuar ngritje për katër vende në mbrojtjen e gazetarëve, sipas Raportit të Reporterëve pa Kufij. Ai ka thënë se ky përmirësim fiton në peshë pasi që sivjet hetohet një rënie e përgjithshme e lirisë së shtypit në Evropë në tërësi në vitin 2018. "Raporti i Reporterëve pa Kufij për këtë vit ka përmendur përmirësimet në marrëdhëniet në mes të mediave dhe qeverisë, duke vënë në dukje se qeveria aktuale duket më e gatshme të flasë me gazetarët dhe mediat në tërësi. Qeveria do ta vazhdojë këtë dialog me gazetarët për një transparencë dhe llogaridhënie



gjithnjë e më të avancuar, duke qenë e vetëdijshme për sfidat që i ka përpara për të krijuar një pasqyrë plotësisht pozitive në përparimin e lirisë së shtypit", ka thënë Haradinaj.

Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka thënë se kushti themelor i demokracisë është liria dhe ndër tiparet themelore të lirisë është shprehja e lirë. Ai ka deklaruar se nuk mund të ketë demokraci lib-

erale pa liri të shprehjes. "Dita Botërore e Lirisë së Shtypit sot e gjen shoqërinë dhe mediet tona në një stad shumë më të avancuar. Megjithatë na duhet ende punë, dialog, transparencë dhe respekt për të garantuar një ambient të sigurt për funksionimin e mirëfilltë të këtij profesioni fisnik. Sot i bashkohemi ndërgjegjësimit për mbështetjen e gazetarëve dhe medieve për punën e tyre të shen-

jtë, plotësisht të vetëdijshëm se ky ndërgjegjësim duhet të jetë përditshmëri e jona. Si ministër i Drejtësisë dhe si pjesë e politikës aktive do të angazhohem për bashkëpunim të plotë me mediet, si shtylla kyçe në mbrojtje të interesit publik të Republikës së Kosovës dhe shoqërisë sonë në përgjithësi. Informimi i drejtë, i saktë dhe në kohë, janë vlera të cilat kemi përgjegjësi t'i mbrojmë pa kompromis", ka thënë ministri Tahiri.

Edhe ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka theksuar se liria e medias është esenciale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe demokracisë. "Republika e Kosovës nga Reporterët pa Kufij është renditur në vendin e 75-të krahasuar me vitin 2017. Jemi për katër vende më lart. Me këtë renditje jemi më së larti në rajon dhe përpara disa shteteve anëtare të BE-së", ka thënë ministrja Hoxha.



Haradinaj: 'Elkos Group', një ndër taksapaguesit dhe punëdhënësit më të mëdhenj në vend

PEJE, 3 MAJ (ER) - Kryeministri Ramush Haradinaj ka vizituar të premten fabrikat e "Egi Group" në kuadër të "Elkos Group", ku është pritur nga pronari Ramiz Kelmendi. Haradinaj ka thënë se si një ndër taksapaguesit dhe punëdhënësit më të mëdhenj në vend, "Elkos Group", me pronar Ramiz Kelmendin, i ka dhënë shtytje ekonomisë së Kosovës. Kryeministri gjatë kësaj vizite është njohur nga afër me rritjen progresive të sasisë së shitjeve në treg të prodhimeve cilësore të

fabrikës ushqimore "PI&KI", të leckave të lagura dhe atë të qeseve të plastikës. "Mora inputet për hapat e ardhshëm që qeveria duhet të ndërmarrë për fuqizimin e prodhuesve vendorë. Kosova me tatimet më të ulëta në rajon si dhe lehtësirat e tjera fiskale, u jep mbështetje prodhuesve për zgjerim të kapaciteteve dhe depërtim në tregjet ndërkombëtare, në të njëjtën kohë për ta rritur numrin e punëtorëve dhe të ardhurat për punonjësit", ka thënë Haradinaj.

Komuniteti arbëresh nga Sicilia viziton Ministrinë e Mbrojtjes dhe ushtrinë

Prishtinë, 3 maj (ER) - Zëvendësministri i Mbrojtjes, Burim Ramadani, dhe gjeneralmajor Gëzim Hazrolli, në emër të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcës së Sigurisë të Kosovës, pritën të premten në vizitë ministrin e Diasporës dhe Investimeve Strategjike, Dardan Gashi, së bashku me një delegacion të komunitetit arbëresh nga Sicilia e Italisë. Zëvendësministri Ramadani së pari i dëshiroi mirëseardhje delegacionit arbëresh, duke shprehur konsideratën e tij të lartë jo vetëm për përkushtimin e këtij komuniteti për ruajtjen e kulturës dhe gjuhës shqipe, por edhe për kontributin e tyre të madh brez pas brezi, duke çmuar në veçanti kontributin e pinjollëve të këtij komuniteti në periudhën e Rilindjes Kombëtare Shqiptare. "Republika e

Kosovës ka për objektiva kryesor integrimin në Bashkimin Evropian dhe anëtarësimin në NATO. Kosova ka orientim perëndimor, ashtu siç është edhe partneri ynë, shteti i Italisë. Pra, shteti juaj ku ju jetoni dhe kontribuoni, anëtar i NATO-s dhe i bashkimit Evropian", u shpreh zëvendësministri Ramadani.

Më pas, delegacioni arbëresh vazhdoi vizitën në Komandën e Forcave Tokësore, duke u pritur përzemësisht në të gjitha repartet e saj. Vizita e arbëreshëve në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në ushtri u zhvillua në kuadër të aktivitetit "Ditët e Arbëreshëve" në Kosovë, të organizuar nga Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike, nën përkujdesjen e kryeministrit të Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj.



Është mbajtur takimi i përbashkët i liderëve të institucioneve shtetërore dhe drejtuesve të ekipit negociator për procesin e dialogut me Serbinë

Kosova shkon në Samitin e Parisit me qëndrim të përbashkët për dialogun

Liderët shtetërorë të Kosovës kanë bërë me dije se në Samitin e Parisit do të shkojnë me qëndrim të përbashkët për procesin e dialogut me Serbinë. Ata kanë bërë me dije se objektivi parësor i Kosovës në këtë proces është anëtarësimi në Organizatën e Kombeve të Bashkuara (OKB). Kjo është bërë me dije nga kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, në një konferencë për medie si nikoqir i takimit të përbashkët me presidentin Hashim Thaçi, kryeministrin Ramush Haradinaj, si dhe drejtuesit e ekipit negociator Fatmir Limaj, Enver Hoxhaj dhe Behgjet Pacolli

tarëve të vet, ndaj fqinjëve dhe ndaj BE-së. Për ne është me rëndësi ky proces. Ne do të marrim pjesë në procese të tilla kudo që të na ftojnë në mënyrë të bashkuar. Qëllimi ynë është i qartë: Kosova në OKB me sovranitet të pacenuar. Kosova do të shkojë edhe në Paris dhe kudo që ftohet", ka theksuar ai.

Veseli ka bërë me dije se të gjithë në takim janë pajtuar që Samiti i Berlinit, që është mbajtur më 29 prill, ka qenë zhvillim pozitiv. "Kemi pasur një takim pozitiv dhe konstruktiv. Samiti i Berlinit është një lajm i mirë për procesin e Dialogut. Samiti i Berlinit është konstatuar nga të gjithë ne se është një lajm i mirë. Të gjithë jemi të vetëdijshëm për procesin historik që po kalon Kosova jonë si shtet i pavarur dhe sovran drejt Organizatës së Kombeve të Bashkuara - OKB-së. Falënderojmë Bashkimin Evropian për përfshirje serioze në këtë proces historik", ka deklaruar Veseli, duke shtuar se është e rëndësishme edhe përfshirja aktive e ShBA-së në procesin e

dialogut. "Ne kemi vetëm një mandat para qytetarëve: shtetin tonë të pavarur dhe sovran dhe respektimin e Kushtetutës së Kosovës. Në këtë proces historik është e rëndësishme që Bashkimi Evropian do të ketë një përfshirje më serioze. Por, po ashtu, është tejet e rëndësishme edhe përfshirja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Dialogu do të jetë transparent dhe çdo vendim do të ketë konsensusin qytetar dhe institucional. Do të jemi të unifikuar, që Kosova të ecë drejt integritetit euroatlantike dhe anëtarësimin në OKB. Me më këtë rast falënderoj presidentin Trump për të gjitha iniciativat që ka pasur deri më tani. Besojmë se në të ardhmen do të ketë një përfshirje edhe më të drejtpërdrejtë të ShBA-së", është shprehur kryeparlamentari Veseli. Ai ka bërë me dije se qëllimi kryesor nga procesi i dialogut me Serbinë është anëtarësimi i Kosovës në OKB. Sipas Veselit, Kosova asnjëherë nuk do të nënshtrohet para Serbisë dhe Rusisë. Kurse sa i përket çështjes së taksës, ai ka thënë se tashmë është bërë

bajati për të. "Taksa është bërë bajat. Nuk e kemi ndërmend të marrim vendim i cili e vë në qoshe asnjë udhëheqës të shtetit të Kosovës. Kurrë nuk do të nënshtrohemi ndaj Serbisë dhe ndaj Rusisë. E marrim vendimin në interes të përbashkët të shtetit me maturi dhe mençuri me atë çka thotë ShBA-ja dhe partnerët tanë në BE. Kështu që, këtë punën e taksës largojeni, se e kemi bërë shumë të madhe pa nevojë. Taksa ka qenë vendimi më dinjitoz i shtetit tonë ndaj Serbisë. Kur kemi vendosur taksën ka qenë përgjigje ndaj Serbisë dhe jo ndaj ShBA-së, Gjermanisë dhe Francës", ka theksuar Veseli.

Liberalizimi i vizave ai ka thënë se duhet të ndodhë pasi që Kosova ka plotësuar më shumë kriteret se të gjitha vendet e tjera. Megjithatë, sipas Veselit, në takimin e përbashkët të liderëve nuk është diskutuar për këtë çështje. "Nuk kemi folur për procesin e liberalizimit të vizave. Kosova i ka plotësuar të gjitha kushtet për t'iu hequr vizat", është shprehur Veseli.

EPOKA E RE**Shqipëri HETEMI**

PRISHTINË, 3 MAJ - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, të premten ka fituar në takim të përbashkët presidentin Hashim Thaçi, kryeministrin Ramush Haradinaj, drejtuesit e ekipit negociator, zëvendëskryeministrat Fatmir Limaj, Enver Hoxhaj dhe Behgjet Pacolli, me të cilët janë koordinuar për pjesëmarrjen në Samitin e Parisit që do të mbahet më 1 korrik. Në këtë takim nuk ka

marrë pjesë bashkëkryesuesi i ekipit negociues Shpend Ahmeti, për të cilin Veseli ka thënë se ka munguar me arsye. Pas përfundimit të këtij takimi kryeparlamentari Kadri Veseli ka thënë se Kosova do të marrë pjesë në Samitin e Parisit me qëndrim të përbashkët. "Kosova është shtet i pavarur dhe sovran, kështu do të jetë përjetë. Nuk do të diskutohet për integritetin dhe sovranitetin tonë. Ne po flasim për obligimet që duhet t'i marrë Kosova si shtet i pavarur dhe sovran ndaj qyte-



Në UP hapet edicioni i nëntë i Panairit Virtual të Karrierë

PRISHTINË, 3 MAJ (ER) - Në Sallën "1 tetori" të premten është hapur edicioni i nëntë i Panairit Virtual të Karrierës (PVK), i organizuar nga Qendra për Zhvillim të Karrierës e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", në bashkëpunim me projektin partner të GIZ-it, DIMAK Kosova. Edicioni i sivjetmë i PVK-së u mbajt sërish bashku me Panairin Nacional të Punës, i organizuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe partnerët e tjerë.

Në hapjen e Panairit Nacional të Punës dhe Karrierës të pranishëm ishin rektori i UP-së, prof. dr. Marjan Dema, ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, zëvendësambasadori në Ambasadën Gjermane në Prishtinë, Jan Axel Voss, udhëhe-

qësja e DIMAK Kosova, Anja Tomic, Nora Hasani-Llapiç nga Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare, përfaqësues të kompanive, studentë dhe të diplomuar.

Të pranishmëve në këtë edicion iu drejtua me fjalë rasti rektori Dema, i cili bëri hapjen zyrtare të Panairit Virtual të Karrierës së UP-së. Ai ka uruar që ky panair ta arrijë misionin e tij për gjetjen e vendeve të reja të punës dhe ofrimin e mundësive për zhvillim të karrierës. "Uroj që ky panair, i ideuar për studentë dhe të diplomuar, të shërbejë për gjetjen e mundësive për qasje në tregun e punës dhe zhvillim të mëtejshëm në karrierë. Ndërkaq, juve punëdhënës dhe ofrues të shërbimeve për karrierë, ju falënderoj për mundësinë që po ua jepni stu-

dentëve dhe të diplomuarve tanë, mundësi këto që do t'u shërbejnë edhe kompanive tuaja për të fituar kadro të përgatitura profesionalisht", ka thënë Dema. Në anën tjetër, hapjen e Panairit Nacional të Punës e bëri ministri Reçica, i cili ka theksuar se ngjarja e sotme është një mundësi e mirë si për punëdhënësit potencialë, po ashtu edhe për punëkërkuessit. Hapjen e panairit e përshëndetën edhe përfaqësues nga DIMAK Kosova, Ambasada Gjermane dhe Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare, të cilët konsideruan se realizimi i këtij panairi paraqet një mundësi unike për ndërlidhjen e punëkërkuessve me tregun e punës.

Në Panairin e Karrierës të UP-së morën pjesë 27 institucione, organizata, qendra dhe zyra.



Panairi Nacional i Punës dhe Karrierës ofroi për punëkërkuessit rreth 2 500 mundësi për vende pune dhe rreth 1 000 mundësi

për punë praktike. Edicioni i sivjetmë u organizua nën moton "Eja, rrjetizohu me punëdhënësit".

Lluka: Telekomi në prag të falimentimit

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 3 MAJ - Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, ka raportuar të premten para anëtarëve të Komisionit Parlamentar Hetimor për Telekomin e Kosovës. Ai ka thënë se Telekomi i Kosovës është pranë falimentimit për arsye të operimit me humbje rreth 15 milionë euro në vit.

Ministri Lluka ka thënë se shqetësues mbetet vendimi gjykatës për kontratën me "Z Mobile", ku është paralajmëruar se kjo kontratë do të dërgohet te përmbaruesi privat. Për shkëputjen e kontratës me "Z

Mobile", Lluka ka thënë se si ministër nuk e ka autoritetin për shkëputje të kontratave të njëanshme me këtë kompani. Sipas Llukës, Telekomi vazhdimisht vitet e fundit ka qenë në gjendje të keqe për shkak të mbipunësimit dhe shumë çështjeve të tjera. Ai ka thënë se zgjidhja ideale për Telekomin është privatizimi, me ç'rast ka bërë me dije se janë katër kompani ndërkombëtare të interesuara për privatizim.

Kryesuesi i Komisionit Hetimor, deputeti i PSD-së, Visar Ymeri, ka deklaruar se duhet vlerësim i tërësishëm për Telekomin, në veçanti për kontratat. Pikërisht për këto, ai ka kërkuar nga min-

istri Lluka që të bëjë një analizë si ministër i linjës për të gjitha kontratat me palët e treta.

Deputetja e Lëvizjes Vetëvendosje, Albulena Haxhiu, ka kërkuar të dijë se cila është arsyeja e moszbatimit të rezolutës së miratuar vitin e kaluar sa i përket çështjes së Telekomit.

Ndërkaq deputeti i LDK-së, Armend Zemaj, ka thënë se Telekomi është degraduar në formë të ndryshme, duke u nisur me mbipunësimin, marketingun dhe pagesat për qira të objekteve. Në këtë mbledhje, edhe deputetja e PDK-së, Blerta Deliu-Kodra, ka kërkuar informacione për katër familjarët e punësuar të anëtarit të Bordit të Telekomit.



Sektori i bujqësisë me potencial për rritje të eksporteve në Kosovë



EPOKA E RE **Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 3 MAJ - Oda Ekonomike e Kosovës (OEK), në bashkëpunim me GIZ-in, në kuadër të projektit Fondi Rajonal i Hapur - Tregtia e Jashtme, kanë realizuar një studim në nivel rajonal mbi gatishmërinë për eksport të sektorit të bujqësisë, respektivisht sektorit të pemëve dhe perimeve. Në nivel rajonal anketimi ka përfshirë 146 kompani, prej të cilave 43 ishin nga Kosova, 36 nga Serbia, 21 nga Bosnja dhe Hercegovina, 19 nga Maqedonia, 15 nga Shqipëria dhe 12 nga Mali i Zi. Sipas një njoftimi të OEK-ut, kompanitë e Kosovës të këtij sektori ndër barrierat kryesore në tregun vendor kanë përmendur vështirësitë për gjetjen e distributorëve (49 për qind), certi-

fikimet e sigurisë ushqimore (37 për qind), treg i vogël për produktet ushqimore (33 për qind), vështirësi në qasjen në financa (26 për qind), kostoja e lartë e lëndës së parë (23 për qind) dhe gjetja e stafit të përgatitur mirë për shitje (23 për qind). Megjithatë, në nivel kombëtar, sipas kompanive respondente, zhvillimi i këtyre kompanive ka qenë i kënaqshëm (49 për qind) konform kushteve dhe ambientit binzesor në vend.

Arsyet kryesore për moszhvillim të pjesës tjetër të kompanive janë përmendur të jenë produktet e shumta nga tregjet e huaja, ekonomia informale, klientët nuk paguajnë me kohë; mungesa e fuqisë punëtore; konkurrenca nga jashtë/imperti; mungesa e tregut, monopolet e krijuara nga politika; çmime të ulëta të

konkurrencës; investime të kufizuara në teknologji të re dhe në stafin profesional. Sipas OEK-ut, mbi gjysma e kompanive të anketuara kanë deklaruar që mund të eksportojnë me kapacitetet aktuale, ndërsa për rreth 9 për qind të kompanive pjesëmarrëse në studim përfshirja në eksport do të kërkonte investime të shumta dhe të papërballeshme për ta. Rreth 21 për qind e kompanive nuk kanë informatën e duhur se çfarë u nevojitet për t'i eksportuar produktet e tyre. "Mungesa e laboratorëve të akredituar në Kosovë mbetet sfidë për mbi 20 për qind të kompanive të këtij sektori, duke rritur kështu koston e prodhimit dhe duke ndikuar në rritjen e çmimit final të produkteve tona, e që si rrjedhojë edhe aftësia konkurruese e çmimeve mbetet

më e vogël. Rreth 19 për qind e kompanive kanë deklaruar të mos kenë aktualisht asnjë certifikim ndërkombëtar, ndërsa një pjesë e madhe e tyre kanë Global GAP dhe HACCP", është theksuar në njoftimin e OEK-ut.

Nga 35 për qind e kompanive që eksportojnë rregullisht destinacion kryesor i eksporteve janë vendet e rajonit/CEFTA: Gjermania, Holanda, Zvicra, Italia, Franca, Bullgaria etj. 42 për qind e kompanive që aktualisht nuk eksportojnë kanë provuar të qasen në tregjet e huaja, por pa pasur sukses. Arsye e dështimit mbeten barrierat jotarifore dhe politike, mungesa e qasjes në informata në vendin e destinacionit, taksat e larta, mospërbushja e marrëveshjeve, konkurrenca e padrejtë etj.

Në nivel rajonal (krahasuar me

vendet e Ballkanit Perëndimor), pothuajse të gjitha kompanitë bëjnë analiza të brendshme ose kanë certifikime. 78 për qind e kompanive të të gjithë rajonit i konsiderojnë produktet e veta të jenë në përputhje me rregulloret e BE-së dhe standardet e sigurisë, përveç shkallës së ulët në Kosovë dhe Mal të Zi. "51 për qind e kompanive kanë HACCP (Maqedoni 95 për qind, Kosovë 23 për qind); 23 për qind Global GAP; 15 për qind nuk kanë certifikim (19 për qind në Kosovë). 34 për qind provuan tregjet e reja të eksportit pa sukses; arsyet kryesore: kushtet e pagesës, mungesa e mbështetjes shtetërore, konkurrenca e pandershme. Pengesat kryesore: konkurrenca në çmim (44 për qind), aksesi në rrjetet e shitjes (40 për qind), qasja në financa (38 për qind)", është thënë në njoftimin e OEK-ut.

General Electric përzgjedhet ofertuesi i preferuar për Termocentralin 'Kosova e Re'

EPOKA E RE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 3 MAJ - Contour Global dhe Qeveria e Kosovës kanë njoftuar të premten se konsorciumi i kompanive të General Electric (GE) është përzgjedhur si ofertuesi i preferuar në tenderin për Inxhinieringun, Prokurimin, Ndërtimin (EPC) dhe Mirëmbajtjen Afatgjatë (LTM) për Projektin e Termocentralit "Kosova e Re".

Siç është njoftuar në shtator të vitit 2018, katër kompani të parakualifikuara u ftuan t'i paraqesin propozimet e tyre teknike dhe financiare.

GE, Contour Global dhe Qeveria e Kosovës planifikojnë që të vazhdojnë negociatën të mëtejshme me qëllim të arritjes së një marrëveshje mbi kushtet përfundimtare.

Karl Schnadt, zëvendës-president ekzekutiv dhe kryeshef operativ i Contour Global, ka theksuar se kjo shënon një hap kyç në zhvillimin e projektit "Kosova e Re". "Jemi të lumtur që do të ecim për-

para me një kompani të nivelit botëror, e cila ka angazhimin dhe aftësitë për ta ndërtuar 'Kosovën e Re' në kohë dhe sipas standardeve më të larta teknike, mjedisore dhe të sigurisë. Ne kemi qenë të kënaqur me procesin rigoroz të tenderimit dhe përgjigjen pozitive të marrë nga tregu", ka thënë Schnadt.

Projekti i Termocentralit "Kosova e Re"

Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Llluka, ka thënë se Qeveria e Kosovës është e kënaqur me interesimin e madh të tregut për projektin "Kosova e Re". "Projekti pasqyron nevojën për kapacitet shtesë energjetik për t'i përbushur nevojat afatgjata të sigurisë së furnizimit me energji elektrike në Kosovë. Përzgjedhja e GE-së si ofertuesi i preferuar e vë Kosovën një hap më afër arritjes së një rezultati të suksesshëm të këtij procesi të filluar shumë kohë më parë me mbështetjen e shumë institucioneve ndërkom-



bëtare. Qeveria do të marrë pjesë në procesin e negociatave me qëllim të përmirësimit të mëtejshëm të kushteve në interes të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Zbatimi i suksesshëm i këtij projekti ka potencialin për ta ndryshuar perspektivën e përgjithshme ekonomike të vendit", ka thënë ministri Llluka.

Prapavija e Termocentralit "Kosova e Re"

Ky projekt shënon një hap të rëndësishëm për ekonominë e Republikës së Kosovës dhe do ta përfaqësojë investimin e drejtpërdrejtë të huaj më të madh të bërë ndonjëherë në vend.

Termocentrali do ta furnizojë ngarkesën bazë energjetike tejet të nevojshme me çmimin më të lirë të mundshëm dhe në mënyrë të besueshme për ta përbushur kërkesën në rritje për energji elektrike në Kosovë në mënyrë të pavarur, pa u mbështetur në import.

Gjatë dekadës së fundit Republika e Kosovës ka importuar energji elektrike në vlerë mbi 500 milionë euro. Duke përdorur teknologjinë më të fundit dhe burimet e bollshme vendore të lëndës djegëse, "Kosova e Re" do të jetë një nga termocentralet më bashkëkohore me qymyr në botë. "Kosova e Re" do të jetë instrumentale për rritjen e cilësisë së jetës së njerëzve.

Termocentrali do të rezultojë me përmirësimin e konsiderueshëm të cilësisë së ajrit duke reduktuar emetimet e ndotësve kryesorë dhe do të kontribuojë në përmirësimin e shëndetit të njerëzve që jetojnë dhe punojnë në rajon. Emetimet e pluhurit do të reduktohen me 93 për qind, ndërsa SOx dhe NOx do të reduktohen me 85 për qind dhe 93 për qind respektivisht, me CO2 të ulur për 38 për qind.

Termocentrali i ri do të ndihmojë në rritjen dhe mbështetjen e zhvillimit ekonomik të Kosovës. Duke ofruar siguri afatgjatë të furnizimit, "Kosova e Re" do t'u japë fund humbjeve vjetore prej 300 milionë eurosh të shkaktuara nga furnizimi aktual i pasigurt i energjisë elektrike në Kosovë. Kjo do të krijojë një ambient atraktiv për investimet e huaja direkte dhe do të mbështesë rritjen në ekonomi.

Vlerësohet se ky investim madhor i Contour Global do ta rrisë bruto produktin vendor (GDP) afatmesëm për së paku 2 për qind, duke nxitur rritje ekonomike vendore dhe rajonale.

Kosova ta fuqizojë brendin e saj për të krijuar mundësi për kontraktim të proceseve afariste te kompanitë kosovare

PRISHTINË, 3 MAJ (ER) - Kosova dhe bizneset e saj kanë potencial për kontraktim të proceseve te bizneset kosovare nga kompanitë e jashtme. Derisa ka kompani të shumta kosovare që ofrojnë shërbime të tilla për kompanitë amerikane dhe të tjera, duhet punuar më tej për promovimin e brendit të Kosovës si destinacion për kontraktim të proceseve afariste (outsourcing). Kjo u tha gjatë tryezës së organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë rreth mundësive të cilat tregu i Kosovës i ofron në fushën e kontraktimit të proceseve afariste (outsourcing) si dhe sfidat të cilat ndikojnë në zhvillim më të ngadalshëm të saj.

Kryesuesi i Komitetit të Teknologjisë dhe Inovacionit të Odës Amerikane, Ardian Hoxha, ka thënë se kontraktimi i proceseve afariste nga kompanitë e huaja te kompanitë kosovare përbën një mundësi të madhe për zhvillimin ekonomik të vendit. Ai ka folur, pos të tjerash, edhe për angazhimin e Komitetit që ai drejton për promovimin e ekonomisë digjitale



në Kosovë si dhe të avancimit të legjislacionit të kësaj fushe. Shefi ekzekutiv i "Melita & Partners", Arben Ymeraga, ka theksuar se siguria ligjore është faktor esencial për ndërtimin e partneriteteve të reja me kompanitë e huaja, duke shtuar se një adresim i duhur i sfidave në këtë sektor dhe prezantim të kapaciteteve do të ndikonte në rritjen e mëtutjeshme të këtij sektori.

Armend Ukshini, përfaqësues i

kompanisë "Kosbit", kompani kjo e cila ofron shërbime për kompani të njohura amerikane si "At&T", "Microsoft", "CISCO", "IBM" e të tjera, tha se deri tek arritja e një partneriteti të ri mes dy palëve në fushën e kontraktimit të proceseve afariste duhet të konsiderohen se krijimi i besimit është i domosdoshëm për partneritete me kompani të huaja, duke shtuar se, pavarësisht prej përparësive aktuale të cilat i ka tregu i

Kosovës, ndërtimi i imazhit të vendit do të ishte një aset për tërheqjen e partnerëve potencialë dhe për krijimin e bashkëpunimeve të reja.

Drejtori ekzekutiv i "Prosperoware", Milot Arifi, ka pohuar se, pavarësisht prej potencialit që ofron Kosova nëpërmjet të rinjve të saj, kapacitetet mbesin të kufizuara për rezultate më të mëdha në këtë sektor. Ai ka thënë se trajnimet janë pjesë e pandashme e

rekrutimit të stafit të ri në këtë sektor si pasojë e mungesës së kuadrore të kualifikuar. Në këtë aspekt, ai ka shtuar edhe nevojën e një avokimi më të fuqishëm të institucioneve përgjegjëse për orientim të të rinjve në profilet ku ofrohen këto shërbime. Arifi, po ashtu, u shpreh se prezantimi i potencialeve të rinisë dhe zhvillimin e hovshëm të bizneseve do të ndikonte në rritje të mundësive në kontraktim të proceseve afariste në Kosovë.



Prishtina organizon 'Manifesta 2022'

Prishtinë, 3 maj (ER) - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka bërë me dije të premten se Prishtina ka fituar të drejtën e nikoqirit të një prej evenimenteve më të mëdha artistike në Evropë, atë të Manifesta 14, i cili do të organizohet në vitin 2022. "Pas Zurichut 2016, Palermo

2018, Marseille 2020, është Prishtina 2022. Në një garë me Vjenën dhe Kievin, bordi i Manifestës ka zgjedhur aplikimin e Prishtinës duke dërguar mesazhin se Ballkani është pjesë e Evropës dhe se mund të kontribuojë. Në tre vjetët e ardhshëm do të punojmë që ky organizim të sjellë

mbi 200 mijë vizitorë dhe të jetë më i miri ndonjëherë. Manifesta do të sjellë artistë, urbanistë dhe intelektualë ndërkombëtarë për të diskutuar, intervenuar e ngritur çështje për hapësirën tonë të përbashkët. Urime Prishtinë!", ka shkruar Ahmeti në llogarinë e vet në "Facebook".

Inaugurohet Qendra e Thirrjeve në Komunën e Mitrovicës

Mitrovicë, 3 maj (ER) - Në Komunën e Mitrovicës është hapur Qendra e Thirrjeve, ku të gjithë qytetarët do të mund t'i adresojnë problemet, kritikën, kërkesat dhe sugjerimet e tyre. Me këtë rast, kryetari i komunës, Agim Bahtiri, është përgjigjur në telefonatën e parë të realizuar nga qytetari të cilit i është ofruar shërbimi i kërkuar.

Kryetari Bahtiri e vlerësoi shumë të rëndësishëm këtë hap të komunës, që ndikon në rritjen e

transparencës dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve. Qytetarët do të kenë mundësi të thërrasin pa pagesë në numrin 080019400 dhe do të jetë në dispozicion çdo ditë nga e hëna deri të dielën, prej orës 08:00 deri në orën 22:00.

Zyrtarët përgjegjës të Qendrës së Thirrjes do t'u ndihmojnë qytetarëve të marrin përgjigje për shumicën e pyetjeve që lidhen me shërbimet komunale.



Filluan punimet në rrugën Nacionale N2, segmenti Nadakovc - Smrekonicë



VUSHTRRI, 3 MAJ (ER) - Zëvendësministri i Infrastrukturës dhe Transportit, Rexhep Kadriu, të premten mori pjesë në fillimin e punimeve në rrugën Nacionale N2, segmenti Nadakovc - Smrekonicë. Zëvendësministri Kadriu ka theksuar se kjo rrugë, bashkë me gjithë infrastrukturën përcjellëse, do të ndërtohet me standarde evropiane. Ai ka shtu-

ar se ky aks rrugor ka rëndësi të madhe jo vetëm për qytetarët e Vushtrrisë, por tërë Kosovën. Kadriu ka theksuar përkushtimin e ministrit Pal Lekaj dhe Qeverisë së Kosovës që të investohet në të gjitha rrugët nacionale me qëllim të lehtësimit të qarkullimit të qytetarëve dhe mallrave. Ndërkaq kryetari i Vushtrrisë, Xhafer Tahiri, duke e falënderuar Ministrinë e Infrastrukturës

dhe Transportit dhe Qeverinë për përkushtimin e treguar, ka kërkuar nga qytetarët që të tregojnë mirëkuptim deri në përfundimin e kësaj rruge. Segmenti i dytë i rrugës Nacionale N2, Nadakovc - Smrekonicë, ka gjatësi 2.5 kilometra dhe ka vlerë investive afër dy milionë euro dhe është pjesë e investimit të zgjerimit të rrugës Nacionale N2, Prishtinë - Mitrovicë.

Ngrihet aktakuzë ndaj dy personave për shpëlarje të parave

PRISHTINË, 3 MAJ (ER) - Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) ka ngritur aktakuzë pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti Special, kundër të pandehurve Sh. H dhe S. H., për shkak të dyshimit se kanë kryer veprën penale "shpëlarje e parave" nga neni 308 i KPRK-së, lidhur me nenin 32, paragrafi 2, nënparagrafi 2.1 i Ligjit për parandalimin e shpëlarjes së

parave dhe financim të terrorizmit. "Sipas aktakuzës, të pandehurit Sh. H. dhe S. H. gjatë vitit 2015, me qëllim të fshehjes apo të maskimit të natyrës, burimit, vendit, dispozicionit, lëvizjes ose pronësisë së pasurisë së përfutur me aktivitetet kriminale, i cili aktivitet ishte ndërlidhur me veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e



paaautorizuar e narkotikeve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 273, paragrafi 2, lidhur me paragrafin 3 të KPK-së, me qëllim që kjo pasuri e kundërligjshme të duket si e ligjshme, me parat të cilat i kanë përfutur nga aktivitetet kriminale, në mënyrë të kundërligjshme kanë blerë banesa", është

thënë në njoftimin për media të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës. Sipas këtij njoftimi, me këto veprime të pandehurit kanë kryer veprën penale "shpëlarje e parave nga neni 308 i KPRK-së, lidhur me nenin 32 paragrafi, 2 nënparagrafi 2.1 i Ligjit për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financim të terrorizmit.

Në Prizren lirohen hapësirat publike të uzurpuara

PRIZREN, 3 MAJ (ER) - Pas zhvillimit të procedurave dhe konstatimit për uzurpim të pronës publike nga Sektori i

Pronës në rrugën "Qenë Qenaj" të lagjes Jeta e Re në Prizren, Drejtoria e Inspektorateve ka interven-

uar në këtë rrugë për t'i liru hapësirat publike të uzurpuara. Me rrënimin e mureve të ndërtuara në hapësirën

publike është mundësuar fillimi i punimeve për realizimin e projektit për ndërtimin e rrugës.



Filozofia dhe etika politike e Ukshin Hotit (5)

Mbi bashkimin e kombit shqiptar



Prof. ass. dr. Sabri
KIÇMARI

Në hapat e parë të saj, pas vitit 1990, demokracia në Kosovë nuk u kuptua drejt. Sistemi njëpartak, në fakt, ia lëshoi vendin sistemit të njëmendësisë politike. Shtypi privat, që kritikonte Lëvizjen Paqësore, shuhej përmes makinacioneve të ndryshme. Mendimi ndryshe anatomohej. Ish-komunistët e Lidhjes Komuniste të Kosovës, të shndërruar në demokratë, sollën një frymë tipike njëpartizmi në thelb, e pluralizmi në formë. Ukshin Hoti do të vërente këtë "avancim të së vjetrës dhe shtypje të së resë, ku përparohet mediokriteti dhe injorohet talenti" (Hoti 1995: 97) dhe do të reagoonte me forcën e argumenteve kundër tij. Ai do të insistonte vazhdimisht që të arrihej te thelbi i demokracisë: debati dhe dialogu. Duke u thirrur në 2.500 vjet të historisë së demokracisë, ai do të konstatonte: "debati dhe jo burgu, ostracizmi e denigrimi do ta revalorizojë të kaluarën dhe do ta begatojë demokracinë" (Hoti 1995: 107).

Demokracia autentike sipas Hotit duhet ti ketë parasysh përvojat e polisit antik të Athinës, rendin parlamentar dhe përpikërinë e britanikëve, patosin oratorik në zhvillimin e gjimnastikës së mendjes të francezëve, idetë e demokracisë amerikane, të përshkruara me mjeshtri nga Alexis de Toqueville, në mbështetje të lirisë së individit dhe ndarjes së pushteteve etj. Demokracia autentike e Ukshin Hotit është në akord të plotë me parimet themelore të demokracisë (sistemin shumëpartiak, zgjedhjet e lira, parlamentin, liritë politike, e drejta e votimit etj.). Hoti madje pledon për akceptimin e tyre, duke synuar që të përcaktojë "atë që do të ishte autentike, si në zbatimin e tyre praktik, ashtu dhe në akceptimin e tyre nga ana e shoqërisë" (Hoti 1995: 220). Demokracia autentike konsiderohet nga ai si pjesë e një orientimi të gjithëmbarshtëm të qytetarëve të Kosovës në procesin e integritimit në Bashkimin Evropian. Demokracia, si formë e vjetër e organizimit shoqëror, mund të qëndrojë gjatë vetëm në rast të lindjes në mënyrë autoktone, duke i marrë parasysh organizimin politik, kushtet, mentalitetin, karakterin dhe veçoritë e vendeve të caktuara.

Ukshin Hoti ndërton teza të forta teorike të bashkimit kombëtar të shqiptarëve pak kohë pasi kishte

ndodhur Bashkimi i Gjermanisë. Ai herë është kuptuar e më shpesh është keqkuptuar në lidhje me këtë nga elita politike. Por, i sigurt në tezat e tij, ai nuk ka hequr dorë nga ato. Arsyetimi i tezës për bashkim është përmbledhur në idenë e maksimalizimit të fuqisë: "Po qe se sipas teorive në fjalë, lufta e kombeve për pushtet (fuqi), është imamente në vetë natyrën e kombit, autorët e tyre nuk janë naivë që të mos e dinë se shqiptarët janë komb ashtu si dhe kombet tjera të formuara dhe se është, po ashtu, në natyrën e këtij kombi, ashtu si dhe te kombet tjera, synimi për t'u shtetëzuar, për të pasur pushtet dhe për ta maksimalizuar fuqinë" (Hoti 1995: 24). Argumentimin e tij për rëndësinë e bashkimit të kombit shqiptar, Ukshin Hoti nuk e bazon në mitologji dhe nacionalizëm primitiv, por në interesin zhvillimor të kombit. Formulimin strategjik e përmbledh në Fjalën e tij të mbrojtjes para Gjykatës serbe në Prizren, më 29. 09. 1994: "Populli shqiptar duhet bashkuar. Këtë e dinë të gjithë dhe askush më nuk e konteston. Ai duhet të bashkohet për shkak se është i njësuar në planin shpirtëror: e ka një gjuhë, një kulturë dhe një histori. Për shkak se është një popull i vjetër evropian i Ballkanit, i cili që herët e ka demonstruar pjekurinë e vet shtetformuese; për shkak se gjithashtu që herët e ka arritur nivelin e duhur të vetëdijes politike për veten, për vendin dhe për interesat e veta në regjion, dhe për shkak se e ka dëshmuar në mënyrë të lavdishme dobishmërinë e vet në të gjitha planet e bashkësisë evropiane të popujve. Nuk i duhet që ta dëshmojë përkatësinë e vet në këtë bashkësi, sepse pavarësisht nga pozita e vet gjeopolitike dhe e pranisë së religjionit islamik në shumicën e pjesëtarëve të tij, ai ka qenë dhe ka mbetur popull evropian. Ai duhet të bashkohet edhe për shkak se e drejta për vetëvendosje është njëra ndër arritjet qenësore të qytetërimit evropian, e drejtë të cilën vetë ajo e ka proklamuar dhe e cila më asnjë popull në Evropë nuk mund t'i refuzohet a t'i mohohet. Popullit shqiptar i duhet një gjë e tillë që të mund të zhvillohet vetë më tej për ta arritur nivelin e përgjithshëm të kësaj bashkësie. E drejta e popullit shqiptar për t'u bashkuar buron edhe nga fakti se ai nuk ka qenë ndonjëherë i pyetur për caktimin e kufijve që e cungojnë nga të gjitha anët" (Hoti 1995: 179).

Në procesin e konstituimit të shtetit të bashkuar shqiptar, Hoti fton që Shqipëria të jetë bartëse e politikës gjithëkombëtare. Ai insiston që të mos rrezikohet ekzistimi i Shqipërisë si shtet. Ai përmbledh si më poshtë interesat vitale të kombit: "Në qoftë se me nocionin komb nënkuptohet


përmbajtja anglo-saksone e tij, dmth. kombi i konstituuar si shtet (nation-state) atëherë do të ishte fare e natyrshme dhe e logjikshme që Shqipëria të jetë bartëse e një politike gjithëshqiptare, sikundër që është e natyrshme dhe e logjikshme që shumica absolute e shqiptarëve të diasporës shqiptare ta synojnë qëllimin e bashkimit, por duke mos e rrezikuar ekzistencën e vet si komb, dhe të shtetit amë - Shqipërisë. Në këtë kuptim mund të flitet për interesat vitale të kombit: a) të ekzistojë si komb; b) si komb i konstituuar në shtet - Shqipëri, dhe c) të bashkohet" (Hoti 1995: 48). Këto teza rreth interesave të kombit shqiptar në Evropën Juglindore janë identike me tezat e ish-kancelarit gjerman Helmut Kohl për bashkimin gjerman: "Rruga drejt bashkimit nuk është shtruar në tavolinën e gjelbër ose përmes planifikimit me dorë të një plani terminësh. Modelet abstrakte ndoshta mund të zbatohen në rrugë polemike, por ato nuk ndihmojnë tutje. Por ne mundemi, nëse vetëm duam, që sot t'i përgatisim ato etapa, të cilat sjellin deri te ky qëllim... Se si do të duket një Gjermani e ribashkuar, nuk e di sot askush. Por, që bashkimi do të vijë, nëse njerëzit në Gjermani këtë gjë e duan, për këtë jam i sigurt" (Kohl 1989).

Njësoj si Profesor Rexhep Qosja, i cili duke e shtjelluar teorikisht procesin e shpërbërjes së Jugosllavisë, vjen në përfundimin se "për shqiptarët mund të jetë zgjidhje e drejtë, e drejtë dhe e përhershme, vetëm bashkimi kombëtar - si zgjidhje që del nga zbatimi i të drejtës për vetëvendosje" (Qosja 1994: 309), edhe Ukshin Hoti shkruan se duke u deklaruar për republikën dhe për bashkimin e trojeve shqiptare në kuadër të proceseve integrative të Evropës, populli shqiptar e tregoi pjekurinë e vet politike. Shqiptarët e shpallën Republikën e Kosovës dhe i deklaruan hapur qëllimet e veta politike: "Në thelb të këtyre qëllimeve nuk qëndron ekspansioni - lakmia për tokat e huaja, por e drejta për t'u kompletuar si komb i Evropës" (Hoti 1995: 80).

Pra, procesin e bashkimit të shqiptarëve duhet konsideruar si të mundshëm brenda suazave të proceseve integruese të Evropës. Shqiptarët janë të aftë për aleanca të qëndrueshme, orientim të qartë përëndimor dhe shekulli i ri ka hapur rrugë të reja për rritjen dhe zhvillimin e tyre: Kosova e pavarur, Shqipëria në NATO, të dyja në rrugë drejt integritimit në BE. Koha po punon në rrjedhën e tezave të Ukshin Hotit. Shembulli i Gjermanisë mbetet udhërrëfyes.

Kritikë

Por, a ka diçka me të cilën nuk mund të pajtohem sot me



Ukshin Hotin? Sigurisht që po. Mjaft subjektiv më duket Hoti në vlerësimin e figurës politike të Mahmut Bakallit. Ai e mbiçmon Bakallin. Dija politike dhe guximi politik i Bakallit nuk ishin as afër atyre të Ukshin Hotit. Nëse i kemi parasysh të gjitha ato që ka shkruar dhe thënë Bakalli gjatë dhe pas vitit 1981, ato kanë qenë në mesataren e elitës politike në Kosovë. Hoti e quan atë demokrat dhe jokomunist, me orientim të qartë liberal në demokraci, elitist në sjellje dhe botëkuptime. Nuk na del i tillë gjatë vitit 1981. Në fjalimin e tij të 6. Prillit 1981, në Mbledhjen e Komitetit Krahinor të Lidhjes Komuniste të Kosovës, Mahmut Bakalli, në akord të plotë me variantin komunist të Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë, shpërfaqë qëndrime të ashpra kundër idesë së Republikës së Kosovës, përmbajtje të qarta antidemokratike dhe antiliberales, duke i cilësuar studentët demonstrues si armiq, nacionalistë e separatistë. Po e japim këtu një pasus të vetëm nga fjalimi i tij më i gjatë: "Qe disa ditë jemi të ballafaquar në krahinën tonë me një situatë tejet të ndërlikuar dhe të vështirë politike e të sigurisë që u krijua me veprim të armikut të brendshëm e u nxit dhe u koordinua nga armiku i jashtëm, i cili synon që me demonstrata dhe aksione të tjera nëpërmes nacionalizmit dhe separatizmit shqiptar të krijoj jostabilizim edhe në Kosovë me qëllim kryesor që të krijojë jostabilitet të Jugosllavisë, të shkatërrojë sistemin e saj socialist dhe vetëqeverisës, integritetin e saj, pavarësinë dhe mosinkuadrimitin e saj" (Bakalli 1981). Ukshin Hoti e arsyeton Bakallin edhe për deklaratat e tilla dhe sjelljet ekzibicioniste. Pyetja logjike për

secilin studiues është e thjeshtë: Cili është heroi - Hoti apo Bakalli? Ky që sakrifikon veten për të vërtetën, të drejtën dhe Republikën, apo ai që del kundër Republikës, i dënon demonstratat dhe i quan studentët armiq? Përgjigjen, besoj, e di secili lexues!

Kam mendim tjetër nga Ukshin Hoti edhe në lidhje me të drejtën e vetos të vendeve anëtare të përhershme të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Ai e arsyeton këtë në këtë mënyrë: "Principi i këtyre vendosur njëherë mund të pengojë disa fuqi të mëdha imperialiste në manipulimin me shumicën formale të votave dhe të ndërmarrin vendime në disfavor për shtetet e vogla ose t'i detyrojnë të marrin pjesë në aktet agresive. Për këtë shkak principi i unanimitetit të fuqive të mëdha mbron jo vetëm interesat e fuqive të mëdha, por gjithashtu, sovranitetin dhe interesat e të gjitha shteteve të tjera" (Hoti 1976: 98). Pikëpamja ime është se përmes nenit 27. Al. 3 të Kartës së Kombeve të Bashkuara është legalizuar një akt pabarazie në marrëdhëniet ndërkombëtare. Përmes këtij neni ju janë dhënë pesë vendeve (ShBA, Mbretërisë së Bashkuar, Francës, Ruisisë dhe Kinës) fuqi jolegjitime. Një e drejtë e tillë e rezervuar është shfrytëzuar për të shmangur veprimet e Kombeve të Bashkuara ndaj vendeve anëtare: Invazioni i Bashkimit Sovjetik në Çekoslovaki në vitin 1968 nuk u dënua nga OKB për shkak të së drejtës së vetos të Bashkimit Sovjetik; Kosova nuk mund të pranohet nga OKB për shkak të aplikimit të vetos nga ana e Ruisisë, përkundër faktit që shumica e shteteve e kanë njohur pavarësinë e saj. **(Fund)**

Prerja e frikës si parabolë

(Fehmi Pireva, "Prerja e frikës", "Doruntina", Prishtinë, 2019, 190 f.)



Prof. dr. Hysen MATOSHI

Pasi ka botuar katër përmbledhje poetike, dy për lexues të vegjël dhe dy për ata të rritur, pasi ka dëshmuar se poezia është një trajtë e veçantë e ligjërimit të tij artistik, emocional e ideor, Fehmi Pireva vjen në rrjedhat e sotme të letërsisë shqipe me një vepër të shkruar në prozë. Nëse nëpërmjet poezisë ka zbuluar të tjerët në veten e tij, më bëhet sikur nëpërmjet kësaj proze, në të kaluarën dhe në tashmen e vendlindjes, e kërkon veten midis të tjerëve. Janë përjetimet e tij, kujtimet e tij dhe të të tjerëve, por që janë për vetëvetë prej tij, ato që na shpijnë në botën e madhe të rrëfenjave interesante të një vendi të vogël.

Gjatë leximit të kësaj proze lind natyrshëm një dilemë: cilit zhanër i përket? Ndonëse nuk është fjala për një prozë të gjatë në aspektin vëllimor (sipas kriterit të Forsterit romani duhet të ketë më shumë se 50 mijë fjalë, ndërsa kjo vepër letrare ka rreth 47 mijë sosh), ajo i plotëson pjesën më të madhe të kriterëve klasifikues zhanrorë për t'u renditur ndër romanet. Së pari, ka një fabul të qëndrueshme, e cila lexuesit të saj ia bën të mundur ta receptojë, pa ndonjë vështirësi, linjën kryesore narrative; së dyti, dimensionin kronologjik i të ndodhurave është ruajtur nëpërmjet faktit se ngjarjet rrjedhin nga mugëtira mitologjiko-arkeologjike e deri te zhvillimet më të reja që sillen "fundin e frikës"; së treti, edhe pse nuk ka një ngjarje bosht, është e qartë se koha e rrëfimit të ngjarjeve kapërcen shekujt - ato me ritmin e ndërimit të pushtuesve e të pushteteve, pasojnë njëra-tjetrën, duke lënë gjurmë

dhembjesh në jetën dhe në kujtesën e banorëve të lagjes; së katërti, prania e narratorit të gjithëdijshëm, i cili rrëfen, drejtpërdrejt ose indirekt, për të ndodhurat e njohura prej tij, si të përjetuara apo si të dëguara, natyrisht duke e relativizuar jo në pak raste gjithëdijen e tij rrëfimore dhe duke bërë vend edhe për imagjinatën e lexuesit.

Nëse në vepra të ndryshme letrare kërkojmë ndërldhjen e fakteve jetësore të autorit me produktin e tij, në romanin "Prerja e Frikës" do të mund të kërkonim në një drejtim të kundërt për të gjetur qoftë edhe ca dromca jobiografike. Ndaj mund të thuhet se, bazuar në një kuantum të dhënash paraletrare, gjithësi arkepitore në planin personal, para se të shkruhej ky roman - ai është jetuar, para se të përshkruhen ngjarjet - ato janë përjetuar. Rrjedhimisht autori nuk ka zgjedhur ndonjë temë të madhe, nuk ka kërkuar burime motivuese përtej ambientit në të cilin ka lindur dhe është rritur si individualitet. Rrëfenjat e ndërldhura janë produkt i përjetimit dhe perceptimit fëmijëror të botës, të njohjes me të panjohurën, me dimensionin fantastik që zhvillohej në lagjen e narratorit dhe në mendjen e tij, që këtu tregohen me një sinqeritet deri në shkallë të naivitetit, madje shpeshherë edhe pa e krijuar një distancë njohëse të dukurive. Autori, në romanin e tij, e rindërton rrëfimin nga një distancë e madhe kohore, duke ruajtur preokupimet kryesore të tij, është një roman për veten dhe gjithëcka ka të bëjë me veten. Si i tillë, një pikëshikimin i subjektivizuar, romani ruan në vete shenja të një sinkretizmi ndërjgjinor, duke nxjerrë në pah edhe aspekte të qarta lirike.

Ndonëse si motivacion është produkt i reagimit të individit, i cili vjen në jetë dhe ngrihet duke mësuar, duke njohur anën enigmatike të jetës dhe jo rrallë edhe duke u habitur,

"Prerja e frikës" ka elemente të romanit të hapësirës. Me pak përjashtime gjithëcka ndodh në një lagje, e cila e shënon përkufizimin hapësinor të personazhit të nënkuptuar si autor, për të treguar historitë e largëta, por edhe ndodhitë pazakonshme dhe ato të përditshme. Hapësira në këtë rast shfaqet edhe si kufi i kohës, përkatësisht kohët tregojnë ndryshimin e tyre brenda hapësirës unike, brenda lagjes. Pse të mos thuhet se është një roman për vendlindjen e ëndrrave, të gëzimeve, të përplasjeve dhe të zhgënjimeve. Romani "Prerja e frikës" përshkohet nga shtresime interesante mitologjike dhe etnologjike. Kuçedra dhe nëna e bunarit përbëjnë dimensionin e një bote fantastike, që shpërfaqet në botën imagjinative të fëmijëve, por njëkohshëm romani gëlon nga pasura etnografike, të përshkruara me një vëmendje të veçantë përgjatë kapitujve të tij. Pa dyshim ndër to janë besëtytnitë e plakave, pastaj edhe insistimi


i tyre për të ruajtur jetën tradicionale zë vend të rëndësishëm për vënie në pah të veçorive tradicionale të jetës në lagje, të cilat shpërfaqen më mirë nëpërmjet përplasjes së koncepteve.

Ka edhe përshkrime interesante të ngjarjeve që qëndrojnë ndërmjet realitetit dhe imagjinatës, sikundër është kalimi i Hasimit me kalë nëpër urën e drunjtë të këmbësorëve dhe "fluturimi" i tij në lumë, përplekja për ta vënë në lëvizje Bulldogun - krenarinë e fëmijëve, lufta për Sheshin e Kumbullave etj., por edhe ngjarje rrëqethëse si ndalimi i ndërimit të shkollës për fëmijët e lagjes, arrestimi i Ilirit, lëvizjet e tankeve kërcënuese përballë shtëpive etj.

Personazhet janë kryesisht prototipa, tipa të modifikuar dhe jo rrallë edhe shëmbëlltyra veristike të njerëzve me të cilët autori ka bashkëjetuar dhe ka ndarë përjetimet në lagjen e jetës së tij. Këtu do të vlen të shprehim shumë rregulla se "çdo shmangie nga personat faktikë,

sikurse edhe nga ndodhitë e vërteta e hitorike, është e rastit". Prerja e frikës së fëmijëve të cilët vononin të ecnin, si një rit që zbatohet nga plakati te bunari i shtëpisë, është funksionalizuar nga autori si një parabolë interesante e prerjes së frikës kolektive, e asaj frike që si komb na kishte vonuar në ecjen tonë drejt lirisë.

Një autor nuk bëhet i madh për faktin se shkruan për ngjarje të mëdha, tema të rëndësishme dhe për persona të famshëm. Fehmi Pireva, me romanin e tij "Prerja e frikës", ka dëshmuar se mund të shkruhen vepra letrare të arrira, në të cilat trajtohen tema e ngjarje të zakonshme, në të cilat bëhet fjalë për njerëz të rëndomtë. Mjeshtëria letrare, më parë se me materien, ka të bëjë me mjetet shprehëse, strukturimin e lëndës letrare, teknikën e rrëfimit etj. Fehmi Pireva, ndonëse ka ruajtur mënyrën tradicionale të rrëfimit, ka dëshmuar se proza është një formë letrare po aq e suksesshme sa edhe poezia e tij.



Katari do ta vazhdojë mbështetjen për Kosovën

PRISHTINË, 3 MAJ (ER) - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pritur të premten në takim ambasadorin e Katarit në Shqipëri, Ali bin Hammad al Marri. Kryeministri Haradinaj e falënderoi për përkrahjen që shteti i Katarit i ka dhënë Kosovës në të gjitha periudhat e shtetndërtimit. Me këtë rast, kryeministri Haradinaj e njoftoi

të ngarkuarin me punë të Katarit në Shqipëri, Ali bin Hammad al Marri, për angazhimin e qeverisë për forcimin dhe konsolidimin e vazhdueshëm të shtetit të Kosovës si dhe për zhvillimet dhe proceset që lidhen me agjendën euroatlantike me synim, anëtarësimin e plotë të Kosovës në NATO dhe në BE. Po ashtu, kryeministri Haradinaj shprehu gatishmërinë për thel-

limin e marrëdhënive ndërmjet dy vendeve, sidomos në fushën e investimeve dhe zhvillimit ekonomik.

Ndërkaq, ambasadori i Katarit në Shqipëri, Ali bin Hammad al Marri, theksoi gatishmërinë e Katarit se do ta vazhdojë mbështetjen për Kosovën në të gjitha fushat, përfshirë përkrahjen për njohje të reja dhe anëtarësimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare.



29 vjet nga falja e gjaqeve në Gjonaj të Hasit

Ngjarja e lavdisë

Tubimi në Kodrën e Pajtimit në fshatin Gjonaj të Hasit do të mbetet çasti më i lavdishëm i faljes së gjaqeve e ngatërresave në Has. Në këtë tubim janë falur rreth 40 gjaqe dhe mbi 30 ngatërresa

Shkruan: BLERIM ÇOÇAJ

Pajtimi i gjaqeve mbetet një nga ngjarjet historike të lavdisë në Kosovë. Më 2 shkurt 1990, me nismën e Anton Çettës, nisi aksioni atdhetar e humanitar i faljes së gjaqeve që mori përmasa të gjera, duke u përhapur anembanë vendit. Ky konsiderohet edhe si viti më i organizuar dhe më frytdhënës i kombit shqiptar që hyri në histori si vit i bashkimit e i pajtimit të popullit shqiptar kudo që jetonte, brenda trojeve etnike dhe mërgatës. Hasmëritë disavjeçare morën fund me një procedurë të tillë ku u desh të përzihej dashuria, dhembshuria, solidariteti dhe mbijetesja. Dikush fali gjakun e babait, dikush të të birit e dikush të vëllait.

Tubimi në Kodrën e Pajtimit në fshatin Gjonaj do të mbetet çasti më i lavdishëm i faljes së gjaqeve e ngatërresave në Has. Në këtë tubim shumë familje nga Hasi dhe qytete të tjera të Kosovës e shtrinë dorën e pajtimit.

Një nga nismëtarët e pajtimit të gjaqeve e ngatërresave në Has, dr. Halil Cikaj, tregon për çastet e formimit dhe angazhimin e Këshillit të Pajtimit në Has. Ai vlerëson se Pajtimi i Gjaqeve në Gjonaj ishte një prej periudhave më të bardha të historisë në Has. "Jam shumë krenar që kam pasur mundësinë ta jap kontributin tim në pajtimin e familjeve të ngatërruara", shprehet Cikaj.

Më 2 shkurt 1990, me nismën e Anton Çettës, nisi në Kosovë aksioni atdhetar e humanitar i faljes së gjaqeve që mori përmasa të gjera, duke u përhapur anembanë vendit. Ky konsiderohet edhe si viti më i organizuar dhe më frytdhënës i kombit shqiptar që hyri në histori si vit i bashkimit e i pajtimit të popullit shqiptar kudo që

jetonte, brenda trojeve etnike dhe mërgatë.

Studentët nga Hasi i Prizrenit nuk qëndruan indiferentë. Ata iu bashkuan karvanit të Çettës. "Ishim një numër bukur i madh i studentëve nga Hasi të cilët menjëherë u angazhuam që të bëhemi pjesë e nismës për pajtimin e gjaqeve", tregon ai.

Në fillim të muajit mars të vitit 1990, studentët nga Hasi ishin takuar për të biseduar rreth formimit të grupit për pajtimin e gjaqeve. Pjesë e takimit të parë ishin studentët: Halil Cikaj, Liman Shatri, Kasum Letaj, Refki Tanushi, Fadil Nerjovaj, Shpend Nerjovaj, Sylejman Martinaj, Fadil Mallakaj, Ahmet Cakaj, Destan Cakaj dhe Shyhrete Hoxhaj. "Në këtë takim u morëm vesh që të organizohemi për pajtimin e familjeve të hasmëruara", kujton Cikaj. Sipas tij, pas këtij takimi studentët nga Hasi u bënë pjesë e karvanit të Çettës. "Fillimisht u takuam me Hava Shalën dhe Mervete Dreshajn. Aty kërkuam instruksione si të kyçemi për aktivitetin e pajtimit të gjaqeve për regionin e Hasit. Na pranuan me kënaqësi si dhe na thanë se mund të fillonim menjëherë me organizim dhe u morëm vesh që të takohemi për konsultime çdo të premte, pas dite në lokalet e Fakultetit Filozofik".

Pas këtij takimi studentëve iu ishte bashkëngjitur edhe studenti Nexhat Çoçaj, i cili në atë kohë punonte edhe gazetar. "Në një darkë e njoftuam Nexhatin për iniciativën tonë. Ai u pajtua që të bëhet pjesë e grupit tonë në takimet e tjera", tregon Cikaj.

Studentët nga Hasi përpiluan edhe planin e veprimit. Përgjegjës të grupit u caktuan: Halil Cikaj, student i Fakultetit të Mjekësisë, Fadil Mallakaj student i Fakultetit të Bujqësisë si dhe Sylejman Martinaj, student i Fakultetit të



Elektroteknikës.

Ata definuan formën dhe mënyrën e takimit me grupet aktive të intelektualëve, që veç kishin filluar të vepronin në Prizren, ku përgjegjës ishin Bajram Kurti dhe Shyqeri Shehu. Bazë e grupit gjatë veprimit në terren u përcaktua shtëpia e Halil Cikajt, i cili u caktua edhe udhëheqës. "Në fillim të marsit sapo u mblodhëm në oborrin e shkollës në Gjonaj, morëm informacionin se grupi i pajtimit i udhëhequr nga prof. Bajram Kurti e Shyqeri Shehu, veç ishin nisur për fshatin Ramajë. Në marrëveshje me shokët menjëherë filluam rrugën për Ramajë dhe iu bashkëngjitëm këtij grupi".

Mbrëmja e parë e takimit të studentëve në Has

Studentët nga Hasi filluan të dilnin në terren. Ata paraprakisht mbajtën takimin e parë në një dhomë të burrave në shtëpinë e Haxhi Kamer Cikajt. Në këtë takim ishin ftuar të gjitha strukturat e fshatit, përfshirë dhe ata të LDK-së. "Gjetëm përkrahje të fuqishme", kujton Cikaj. "Të gjithë njerëzit që kishin autoritet ishin në përkrah-

jen tonë, deri në ditën e fundit të aksionit".

Grupi që ishte marrë me aktivitete të përhershëm përbëhej nga: Halil Cikaj, Nexhat Çoçaj, Kasum Letaj, Darsim Çollakaj, Gëzim Duraj, Shaban Osmanaj, Hate Totaj, Ajne Çoçaj, Nazmije Totaj, Melihate Çoçaj, Shemsije Çoçaj, Florije Çoçaj, Agim Laqaj, Flamur Shehaj, Sadri Hodaj, Sylejman Martinaj, Fadil Mallakaj, Liman Shatri, Darsim Çollaku dhe Flamur Shehaj.

Dr. Cikaj thotë se puna në terren nuk ishte e lehtë. "Në një fshat familjari i të vrarit na quajti 'rrugaçë të Prishtinës'". "Po ashtu, duhet të ceket edhe një rast interesant, ku prindi i një djali të vrarë ishte pajtuar ta falte gjakun e djalit, por kërkonte, përveç studentëve dhe profesorëve, të mos vinin të tjerët në shtëpinë e tij". Cikaj kujton dhe një moment ku djali betohej se do ta falë gjakun e babait nëse gjendet dorasi. "Kadri Bislimi e kishte të vrarë babin, po nuk dinte se kush ishte vrasësi. Ai bënte thirrje publike që të deklarohet kryesi i vrasjes, sepse kishte vendosur se do t'ia falë gjakun", kujton ai.

Grupi i pajtimit të familjeve të

ngatërruar në Has, pas punës në terren, vendosi që të mbajë një tubim përmbyllës. Ky grup u pajtua që tubimi të mbahet në fshatin Gjonaj. Tubimi u moderua nga Nexhat Çoçaj. "Fshati Gjonaj, edhe pse ishte më i madhi në Has, kishte më së paku ngatërresa".

Organizatorët kishin rënë në sy të organeve të policisë së Serbisë. Ata ishin marrë në pyetje disa herë nga policët. Frika më e madhe ishte nga policët shqiptarë të cilët ishin pjesë e organeve të Serbisë. "Nuk mbahej në mend një mobilizim i tillë. Fjalimi më domethënës për ne dhe kohën ishte ai i prof. Hajdar Mallakut", kujton Cikaj. Në këtë tubim janë falur afër 40 gjaqe dhe mbi 30 plagë.

Pajtimin e Gjaqeve në Gjonaj askush s'e kujton

Dr. Halil Cikaj shprehet i zhgënjyer për moskujtimin e kësaj date historike në Has. Sipas tij, disa nga pjesëmarrësit e Këshillit të Pajtimit, pas përfundimit të luftës, vrapuan pas pushtetit. "Fatkeqësisht, kjo ngjarje pas luftës nuk u kujtua asnjëherë". Ai thotë se për angazhimin dhe pajtimin e familjeve të hasmëruara në Has është shkruar shumë pak. "Turpi kulmon mbi ata që në atë kohë iu kishte dhënë besimi nga shokët studentë, që të mbanin shënime për arkivë, por një gjë e tillë nuk ndodhi asnjëherë". Kjo datë historike përkujtohet vetëm nga ShKA "Malësori". "ShKA 'Malësori' organizon Festivalin 'Hasi Jehon', por kjo ngjarje është përmendur vetëm dy herë dhe atë shkarazi. Cikaj shpreson se në të ardhmen Pajtimi i Gjaqeve në Has, do të përkujtohet dhe shkruhet më shumë. 'Kjo ngjarje historike meriton të kujtohet e të shkruhet më shumë për të', shprehet ai.



E rrallë

"Dera e qelisë" shitet për mijëra dollarë

Një vizatim i thjeshtë i realizuar nga ish-presidenti i Afrikës së Jugut, Nelson Mandela, ku paraqitet dera e qelisë së burgut Robben Island, ku u mbajt për 18 vjet, u shit të enjten në Nju Jork për 112 575 dollarë. "Dera e Qelisë, Robben Island", e përfunduar në vitin 2002 nga fituesi i Çmimit Nobel të Paqes tejkaloj pritshmëritë e shtëpisë së ankandeve Bonhams, e cila kishte vënë një vlerë mes 60-90 mijë dollarë.




FOTO E DITES



Zyrtarët indianë të pyjeve dhe policia në Guwahati shihen duke ndjekur një elefant i cili kishte hyrë në këtë zonë. /AFP/

E jashtëzakonshme

Gjarpri me tre sy

Një gjarpër me tre sy është zbuluar në veri të Australisë. Zvarraniku me një gjatësi prej 40 centimetrash ngordhi pak javë pasi u gjend. Sipas zbuluesve të tij, ky gjarpër nuk arrinte dot të gjuante pikërisht se kishte tre sy.



BARSOLETA E DITËS



Burri: E dashur, më duhet të tregoj një të vërtetë të tmerrshme.
Gruaja: Fol i dashur!
Burri: Firma ka bankrotuar. Babai më la pa hise, veturën e kam bërë llom. A do të më duash ende?
Gruaja: Natyrisht i dashur, vetëm se do të më mungosh shumë!



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

"HOW TO TRAIN YOUR DRAGON; The Hidden World" 3D

I Animuar/Aksion Aventure; 1 ore 44 min

Rolet: Jay Baruchel, America Ferrera, Cate Blanchett, Kit Harrington, Craig Ferguson, F. Murray Abraham, etj.
Regjia: Dean DeBlois



Në ora 20:00

"CAPTAIN MARVEL" 3D

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 2 ore 08 min

Rolet: Brie Larson, Samuel L. Jackson, Ben Mendelsohn, Djimon Hounsou, Lee Pace, Gemma Chan, Annette Bening, Jude Law, etj.
Regjia: Anna Boden, Ryan Fleck



Në ora 18:00 (gjate vikendit ne ora 14:00 dhe 18:00)

"THE KID WHO WOULD BE KING"

Aventurë/Familjar/Fantazi; 1 ore 50 min

Rolet: Louis Ashbourne Serkis, Dean Chaumoo, Tom Taylor, Rhianna Dorris, Angus Imrie, Rebecca Ferguson, Patrick Stewart, etj.
Regjia: Joe Cornish




Në ora 22:00

"U S"

Horror/Triller; 1 ore 56 min

Rolet: Lupita Nyong'o, Winston Duke, Elisabeth Moss, Tim Heidecker, Yahya Abdul-Mateen II, Anna Diop, Evan Alex, Shahadi Wright Joseph, Madison Curry, Cali Sheldon, Noelle Sheldon
Regjia: Academy Award-winning visionary Jordan Peele



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

 <p>DASHI Çështjet ligjore për ju sot do të jenë të rëndësishme. Një marrëveshje e re do t'ju sjellë përfitime të shumta.</p>	 <p>DEMI Jeni shumë të ngurtësuar sot dhe nuk mundi të shpreheni në ambiente të caktuara. Do të duket sikur çdo gjë që thoni e thoni gabim.</p>	 <p>BINJAKËT Ndiheni mjaft të karikuar sot dhe falë Marsit në shenjë ju do të jeni një miks pasion dhe energjie pozitive që do ta mbështjellë këdo që ju rri pranë.</p>	 <p>GAFORRJA Sot nuk është dita juaj dhe kjo vërehet në çdo çast dhe në të gjitha situatat që, përveçse do t'ju tensionojnë, nuk do të sjellin asgjë të mirë.</p>	 <p>LUANI Sot do të merrni një lajm nga shumë larg. Një person që keni kohë pa u dëgjuar do t'ju bëjë një kërkesë për të ardhmen.</p>	 <p>VIRGJËRËSHA Keni kohë që po mendoni për një ndryshim në karrierën tuaj dhe duket se sapo ka ardhur koha.</p>
 <p>PESHORJA Do të jeni të mbërthyer nga emocione dhe kujtime jo shumë të mira nga e kaluara. Ndiheni disi të trazuar shpirtërisht sot.</p>	 <p>AKREPI Mirëqenia është një pjesë e rëndësishme e ditës suaj. Po përkujdeseni të jeni sa më i shëndetshëm dhe në humor.</p>	 <p>SHIGJETARI Dita e sotme do të jetë një nga ato ditët që do ta kujtoni me mjaft nostalgji më vonë. Çdo gjë ju bën të ndiheni të përkëdhelur e fatit.</p>	 <p>BRICJAPI Nuk po e bëni gjumin qetë për shkak të një vendimi që duhet të merrni. Edhe pse ju duket e vështirë, mbase do të jetë fillimi i një cikli të ri për ju.</p>	 <p>UJORI Nëse jeni elastik sot do t'ju ndodhin vetëm gjëra të bukura. Një aureolë optimizmi do t'ju shoqërojë përgjatë gjithë ditës.</p>	 <p>PESHQIT Nuk jeni shumë të arsyeshëm për shpenzimet që po bëni sot. Megjithatë familjarët dhe miqtë po ju paralajmërojnë, nuk doni t'i merrni parasysh fjalët e tyre.</p>

Fejohet kryeministrja e Zelandës së Re



Kryeministrja e Zelandës së Re, Jacinda Ardern dhe partneri i saj prej kohësh, Clarke Gayford, janë fejuar. Çifti, që janë prindër të një vajze dhjetëvjeçare, Neve, janë fejuar pas Pashkëve, ka njoftuar zëdhënësja e Ardernit, shkruan

"Nzherald". Ata mësohet se festën e Pashkëve e kanë kaluar në Mahia, te familja e Gayfordit. Zëdhënësja e kryeministres ka thënë se ajo pas festës është duke bartur unazë në gishtin e mesëm të dorës dhe jo në gishtin tradicional të unazës.

Aktorja Keira Knightley, në pritje të fëmijës së dytë



Aktorja e njohur Keira Knightley ka konfirmuar shtatzëninë e dytë në koktejin e Chanel J12 në Paris. Kjo ndodhi kur ajo po merrte pjesë në ndejën e

organizuar nga Chanel J12 dhe u shfaq për herë të parë me bark të fryrë. 34-vjeçarja vendosi njëren dorë në bark dhe dukej e mbushur përplot dashuri.



Kim xhiron videoklip me shoqen Paris

Paris Hilton dhe Kim Kardashian po bashkëpunojnë. Të dy yjet janë parë së bashku në sheshxhirimin e videoklipit për Dimitri Vegas & Like Mike si dhe bashkëpunimit të ri të Paris "Best Friend's Ass"

në Los Angeles. I pranishëm aty ishte edhe ylli i Ru Paul's Drag-Derrick Barry. "Projekt sekret me Kim Kardashian. S'mund të ndaloj së shikuari në të pasmet e shoqes sime të ngushtë", ka shkruar Paris në "Instagram".

Cardi B u kthen përgjigje adhuruesve që e komentuan në fotografinë e saj



Reperja amerikane Cardi B ka reaguar ndaj komenteve të fansave që kanë bërë për fotografinë e publikuar nga ajo. Cardi ka thënë se fansat e saj nuk kanë guxim të dalin në transmetime "live".

"Ju gjithmonë përdorni 'Photoshop'. Ju nuk e tregoni veten kurrë në transmetime 'live' sepse keni të pasme plot celulit dhe aspak atraktive", u shpreh Cardi. Në këtë fotografi thuhet se janë shfaqur pjesët intime të reperes.



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"

TEL: 045 82 82 82

Gërbeshi: Për hir të kampionatit duam fitore ndaj Prishtinës

Kampionia në fuqi, Drita e Gjilanit, është e vendosur ta ndalë Prishtinën në ndeshjen që zhvillohet sot (e shtunë). "Jemi të gatshëm për të gjitha ndeshjet deri në fund të kampionatit dhe në secilën prej tyre do ta japim maksimumin. Për hir të kampionatit do të luftojmë ndaj secilit kundërshtar për fitore, edhe në ndeshjen ndaj Prishtinës. Kemi respekt për kundërshtarin, por synimi ynë është fitorja. Për këtë ndeshje mungesë të vetme e kemi Liridon Lecin", ka thënë Fidan Gërbeshi për "Epokën e re"



Lojtarët premtojnë angazhim në çdo ndeshje, me lojë të bukur dhe rezultate pozitive. Andaj të dielën e jani në stadium, shijojeni paraqitjen e bukur që po e bën klubi ynë i zemrës, KF Ferizaj", thuhet në njoftimin e Ferizajt.

EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

